



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 68 regjistër (JR)
Datë 11.10.2021

Nr. 10 i vendimit
Datë 04.02.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 04.02.2025, ditën e martë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 68/2021 (JR), datë 11.10.2021, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Dritan Marku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 411, datë 05.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Marku.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 42 dhe 179/b të Kushtetutës; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet në parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Dritan Marku (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu kontrollin për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) ka mosdeklarim të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Dritan Marku bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 411, datë 05.07.2021, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dritan Marku, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë [...]”.
6. Ky vendim është marrë mbështetur në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si më poshtë:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, në referim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim të tij, në referim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e kriterit të pasurisë dhe ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësia.

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

7. Kundër vendimit nr. 411, datë 05.07.2021, të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Dritan Marku, duke kërkuar nga Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe në përfundim të gjykimit të vendosë: *Prishjen e vendimit nr. 411, datë 05.07.2021 dhe dërgimin e çështjes Komisionit për të vazhduar më tej procedurën e rivlerësimit për kriteret e mbetura pa u vlerësuar. Ose: Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNj; çeljen e shqyrtimit gjyqësor; administrimin e provave të reja dhe hetimin e dy kriterëve të tjera; ndryshimin e vendimit nr. 411, datë 05.07.2021, të Komisionit duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Dritan Marku, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë.*
8. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, ka depozituar edhe disa akte shkresore¹, për të cilat ka kërkuar administrimin e tyre si prova të reja. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që, në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, të rezervojë të drejtën për paraqitjen e provave të reja, të cilat për shkaqe objektive nuk u paraqitën prej tij as gjatë hetimit administrativ dhe as bashkëlidhur ankimit.
9. Në datën 30.01.2025, pas njoftimit për caktimin e datës së gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit dorëzoi parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe, bashkëlidhur tyre, dorëzoi edhe disa akte shkresore², për të cilat kërkoi administrimin e tyre si prova të reja.

¹ Të cilat subjekti i rivlerësimit i ka referuar në ankim: 1. shkresa nr. {***} prot., datë 17.07.2020, e Avokatit të Popullit; 2. certifikatë e vdekjes së shtetasës R. D.; 3. praktika e aplikimit të noterit pranë ASHK, Vlorë, për pajisjen me kartelë pasurie të subjektit; 4. deklaratë noteriale në lidhje me të ardhurat e realizuara nga shtetasi A. D. në shtetin italian.

² Të cilat subjekti i rivlerësimit i ka referuar në parashtrime: 1. statement bankar nga BKT, Dega Vlorë, për shoqërinë "{***}" ShPK, nga data 01.01.2004 deri më datë 31.12.2005; 2. kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 26.09.2024, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Vlorë, drejtuar z. F. A. në lidhje me vjetërsinë në punë dhe vërtetimin e pagës; 3. kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 03.08.2023, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Vlorë, drejtuar z. F. A. në lidhje me vërtetimin e pagave; 4. vërtetim nr. {***} prot., datë 21.06.2024, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Vlorë, në lidhje me znj. V. A. për përfitimin e pensionit të pleqërisë me datë fillimi 01.08.1984; 5. vërtetim nr. {***} prot., datë 21.06.2024, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Vlorë, në lidhje me z. S. A. për përfitim të pensionit të pleqërisë me datë fillimi 01.08.1984; 6. kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 05.10.2018, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Vlorë, drejtuar znj. L. LL. në lidhje me vjetërsinë në punë dhe masën e pensionit.

IV. Gjykimi i ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelistit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Dritan Marku, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

11. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 411, datë 05.07.2021, të Komisionit, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

13. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për çelje të hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

13.1. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, referuar akteve shkresore bashkëlidhur ankimit dhe atyre bashkëlidhur parashtrimeve me shkrim, bazuar në analizën për pranueshmërinë e tyre në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë procesit në Komision, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj dhe në konsideratë edhe të

parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronjat “a”, “b”, e “d” të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmoi se për këto akte, nuk plotësohen kërkesat e dispozitave të sipërcituara ligjore dhe, për rrjedhojë, vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit për marrjen e tyre si prova të reja në gjykim.

13.2. Në vijim të konkluzionit të mësipërm, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet dokumentacionit të fashikullit të administruar gjatë procesit në Komision, për të cilin nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të zhvilluar në Komision dhe vlerësimi i trupit gjykues

14. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

14.1. Vendimi i Komisionit është i paragykuar dhe i paracaktuar, i marrë mbi bazën e një hetimi dhe vlerësimi administrativ të paplotë, pa u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016. Konkluzionet e Komisionit janë nxjerrë në shkelje të parimeve themelore procedurale, pasi ndaj subjektit të rivlerësimit është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, nenit 4, pikat 5 dhe 6, nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

14.2. Komisioni nuk ka qenë i pavarur dhe i paanshëm në të gjithë procedurën e ndjekur dhe nuk i dha kohën e nevojshme ankuesit të paraqiste provat që ai i konsideronte të domosdoshme për të hedhur poshtë gjetjet tërësisht të pabazuara edhe të pavërteta, për të cilat Komisioni i kishte kaluar barrën e provës.

14.3. Në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, ankuesi nuk është dëgjuar drejtësisht, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Komisioni i ka kaluar vetëm formalisht barrën e provës, ka nxjerrë konkluzione që përbëjnë shkak shkarkimi pa ia njoftuar paraprakisht subjektit dhe duke mos i dhënë asnjë mundësi për t’u mbrojtur.

15. Trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin e fashikullit të çështjes lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për parregullsi në procedurën e ndjekur nga Komisioni, konstaton dhe vlerëson se procesi i rivlerësimit kalimtar për ankuesin, ka nisur dhe është zhvilluar nga Komisioni bazuar në nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës. Trupi gjykues i Komisionit, pasi ka administruar dhe shqyrtuar raportet e institucioneve ndihmëse të parashikuara në ligj, me vendimin nr. {***}, datë 18.11.2019, ka vendosur të fillojë hetimin administrativ. Me vendimin nr. {***}, datë 25.05.2021, trupi gjykues i Komisionit ka vendosur të përfundojë hetimin administrativ, duke i njoftuar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit, si dhe i ka

kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar më datë 25.05.2021 për rezultatet e hetimit dhe analizën financiare, si dhe për të drejtën për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, duke i lënë afat për paraqitjen e shpjegimeve lidhur me to dhe paraqitjen e provave deri më datë 04.06.2021. Ky afat, me kërkesë të ankuesit, fillimisht është shtyrë nga Komisioni me vendimin e datës 02.06.2021, deri më datë 07.06.2021. Në vijim, përsëri me kërkesë të ankuesit, afati për paraqitjen e shpjegimeve dhe provave është shtyrë deri më datë 22.06.2021. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar³ pranë Komisionit prapësimet dhe provat e tij në kuadër të kundërshtimit të rezultateve të hetimit. Më pas, trupi gjykues i Komisionit, nëpërmjet vendimit nr. {***}, datë 28.06.2021, ka caktuar seancën dëgjimore më datë 29.06.2021, e cila, me kërkesë të përfaqësueses ligjore të ankuesit, është shtyrë për në datën 30.06.2021, ora 10:00. Në këto kushte, vlerësohet se nga tërësia e veprimeve hetimore dhe procedurale të Komisionit, nuk rezultoi ndonjë situatë konkrete që të ketë ndikuar në ushtrimin e të drejtave të subjektit të rivlerësimit apo që mos t'i jenë dhënë lehtësitë e nevojshme kohore për të paraqitur mbrojtjen dhe provat e nevojshme. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e ankuesit se procedura e ndjekur nga ana e Komisionit ka qenë në shkelje të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, vlerësohen të pabazuara në fakte.

16. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni i ka kaluar vetëm formalisht barrën e provës, pasi në fakt nuk i ka dhënë kohë për paraqitjen e provave, me argumentin se këto prova nuk ishin të nevojshme, çfarë, sipas tij, tregon se vendimmarrja ka qenë e paracaktuar dhe e paragjykuar, trupi gjykues vlerësoi se, përveç aspektit kohor, i cili u trajtua më lart, subjekti ngre pretendime edhe sa i takon mospranimit të kërkesës së tij për paraqitjen e provave mbi të ardhurat e blerësit A. D. Në lidhje me këtë kërkesë, referuar procesverbalit të seancës dëgjimore, trupi gjykues konstatoi se përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit ka kërkuar kohë për të paraqitur një provë që lidhet me të ardhurat e blerësit të apartamentit të subjektit në Vlorë. Komisioni, pasi ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë, ka vlerësuar se: *Paraqitja e kësaj prove lidhet me një element i cili nuk i është ngarkuar subjektit të rivlerësimit si barrë prove, burimi i ligjshëm i të ardhurave të personit, por veprimet juridike të kryera lidhur me atë kontratë, në këto kushte, trupi gjykues nuk pranon kërkesën tuaj, duam t'ju kujtojmë se të gjitha veprimet e qëndrimet e subjektit do të mbahen në konsideratë në vlerësimin e tij përfundimtar në raport me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.* Sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka shqyrtuar dhe ka mbajtur qëndrim në lidhje me kërkesën e përfaqësueses së subjektit të rivlerësimit, duke bërë vlerësimin e kësaj prove sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, në raport me barrën e provës për çështjen konkrete. Sa më sipër, pretendimi i ankuesit për vendimmarrje të paragjykuar dhe të paracaktuar, vlerësohet i pambështetur.
17. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se Komisioni, përveç rezultateve të hetimit, nuk i ka njoftuar qartë dhe nuk i ka bërë prezent shkeljen që dyshohet se është kryer, motivin përkatës, argumentet, bazën ligjore, si dhe provat ku mbështet konkluzionin e tij, duke e bërë të pamundur mbrojtjen, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e dosjes së Komisionit, konstatoi se

³ Protokolluar në Komision në datën 25.06.2021.

në rezultatet e hetimit administrativ, janë treguar gjetjet e Komisionit për çdo pasuri dhe i është kaluar subjektit barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime për të provuar të kundërtën, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni, në këtë fazë të procesit, nuk mund t'i komunikonte ankuesit konkluzione për problematikat e dyshuara lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të pasurive, apo lidhur me cenimin e besimit të publikut, përderisa procesi vazhdonte dhe do të zhvillohej edhe seanca dëgjimore ku subjekti, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit, kishte të drejtë të paraqiste prova e shpjegime plotësuese, nëpërmjet të cilave mund të përmbyste konstatimet paraprake të rezultateve të hetimit. Nëse Komisioni do të konkludonte në përfundim të hetimit paraprak, atëherë ai do të paragjykonte çështjen, për rrjedhojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit vlerësohet i pambështetur.

18. Lidhur me pretendimin e ankuesit se vendimi i Komisionit ka qenë i paragjykuar dhe i paracaktuar, trupi gjykues çmon se fakti që Komisioni ka kryer një vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve në raport me vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, nuk do të thotë që ai ka paragjykuar apo paracaktuar vendimin. Komisioni, në arsyetimin e vendimit, ka treguar situatën faktike të konstatuar mbi bazën e analizës së provave të administruara, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me to, si dhe bazën ligjore mbi të cilën e ka mbështetur vendimin për dhënien e masës disiplinore ndaj ankuesit. Për sa më sipër, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit u vlerësua i pabazuar.
19. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka cenuar të drejtën e tij për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, pasi nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në përputhje me kriteret e referuara në jurisprudencën e GJEDNj-së⁴, trupi gjykues vlerëson se Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën e tij, lidhur me analizën dhe vlerësimin e këtij pretendimi, duke mbajtur qëndrimin se kuadri ligjor i procesit të rivlerësimit kalimtar ka kaluar testin e kontrollit kushtetues nga Gjykata Kushtetuese⁵ dhe të kontrollit të GjEDNj-së⁶. Në qëndrimin e tyre, Gjykata Kushtetuese dhe GjEDNj-ja kanë vlerësuar se dispozitat ligjore, mbi të cilat mbështetet krijimi dhe funksionimi i institucioneve të rivlerësimit kalimtar, janë në përputhje me Kushtetutën dhe ofrojnë garanci të plota të procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Për sa më sipër, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit u vlerësua i pabazuar.

C. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimi i trupit gjykues

➤ *Lidhur me pasurinë e paluajtshme apartament banimi 2+1, me sipërfaqe 103,07m², të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë:*

20. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit mbi saktësinë e deklaramentit dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj se: *përveç mungesës*

⁴ Subjekti i referohet kryesisht çështjes Volkov kundër Ukrainës.

⁵ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, mbështetur në Opinionin nr. CDL-AD(2016) 036 të Komisionit të Venecias: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)036](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)036).

⁶ GjEDNj-ja në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 295-300 të vendimit.

së koherencës në deklaratime, përpjekja e subjektit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave që lidheshin me justifikimin e burimeve të kësaj pasurie dhe mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, e vendosin subjektin në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 3 të nenit 61, dhe pikës 5, shkronjat “a” dhe “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

21. Këtë vlerësim Komisioni e ka bërë bazuar në konstatimet se:

21.1. Lidhur me saktësinë e deklaratimit: *mospërputhja e deklaratimeve të subjektit me përmbajtjen e kontratës së shitblerjes së pasurisë në fjalë, lidhur me vlerën dhe kohën e kryerjes së pagesave për pasurinë “apartament”, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaratimit të pasaktë, lidhur me këtë pasuri, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

21.2. Lidhur me burimin e deklaruar si dhuratë nga vjehri: *Lidhur me burimin e të ardhurave të vlerave monetare 400.000 lekë që vjehri i subjektit depozitoi cash në llogarinë e përbashkët me subjektin, ky depozitim nuk provon pronësinë e fondeve dhe burimin e transfertës prej 526.275 lekësh, apo destinacionin e transaksionit kryer nga kjo llogari për shoqërinë “{***}” ShPK, me përshkrim: “Për F. SH. detyrim”.*

21.3. Lidhur me burimin e deklaruar nga huatë e shtetasve F. A. dhe K. D.: (i) *Trupi gjykues vlerëson se subjekti, gjatë hetimit, ka bërë një kualifikim të burimeve të huasë, i cili nuk përputhet me parashikimet e kontratës së huasë të nënshkruar mes palëve. (ii) Subjekti i rivlerësimit, lidhur me personat e tjerë të lidhur, shtetasit K.D. dhe F.A., rezultojnë jo vetëm të ketë ndryshuar burimin e krijimit të shumave të dhëna hua, nga person fizik në shoqëri tregtare, por gjendet i ndryshëm edhe nga deklarimi i subjektit mbi pagesën e vlerës, pasi rezultoi se kjo pagesë ishte kryer nga shoqëria “{***}” ShPK, dhe i pambështetur në prova pasi nuk ka rezultuar nga hetimi asnjë dokument ligjor që të krijojë bindjen se dy shoqëritë kanë marrë përsipër ndonjë detyrim lidhur me apartamentin e subjektit.*

22. Subjekti i rivlerësimit i ka kundërshtuar në ankim konstatimet e Komisionit lidhur me vlerën dhe kohën e pagesës së blerjes së këtij apartamenti, duke pretenduar:

22.1. Deklarimet e subjektit në DPV-të e viteve 2005, 2012 dhe në deklaratën *vetting* janë të qarta dhe përputhen në mënyrë të plotë. Në vitin 2005, pavarësisht se kontrata e porosisë ka qenë shkresë e thjeshtë, subjekti ka deklaruar me vërtetësi vlerën e apartamentit, faktin që nga kjo vlerë është zbritur shuma 420.900 lekë, si dhe detyrimi i mbetur. Më tej, janë kryer deklaratime për këtë apartament në DPV-të e viteve 2012 dhe 2013 dhe ato janë pasqyruar pa asnjë kontradiktë apo mospërputhje në deklaratën *vetting*. Bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, DPV-të vjetore të paraqitura më parë në ILDKPKI mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji.

22.2. Si në DPV-të e viteve 2005 dhe 2012, ashtu dhe në deklaratën *vetting*, vlera e apartamentit është deklaruar saktë. Apartamenti ka kushtuar 4.000.000 lekë, nga të cilat 3.480.000 lekë i janë paguar shoqërisë dhe 519.430 lekë janë shpenzuar për kryerjen e punimeve, të cilat janë dokumentuar në dy procesverbale me shumat respektive 420.900 lekë dhe 98.530 lekë. Në

DPV-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar se punimet në vlerën 420.900 lekë, do t'i kryente vetë, sipas dakordësisë me njërin prej ortakëve të shoqërisë që në momentin e porositjes. Përveç punimeve të dakordësuara në vitin 2005, ka kryer edhe disa punime të tjera me vlerë 98.530 lekë. Vlera e apartamentit ka mbetur e njëjtë, pavarësisht kryerjes së një pjese të punimeve nga ai vetë, duke u zbritur vlera respektive nga çmimi i apartamentit.

22.3. Ndryshe nga sa konkludon Komisioni në vendim, se ankuesi nuk ka deklaruar zvogëlimin e detyrimit financiar të mbetur për çdo vit, ai e ka deklaruar këtë detyrim jo vetëm në DPV-në e vitit 2005, por në të gjitha DPV-të vjetore. Në DPV-të e viteve 2005-2011, subjekti ka deklaruar detyrimet financiare ndaj shoqërisë në vlerën 579.100 lekë. Në DPV-në e vitit 2012, ka deklaruar se janë bërë edhe rakordimet përfundimtare dhe se detyrimi i mbetur është 480.000 lekë, për shkak se një pjesë e punimeve, në vlerën rreth 100.000 lekë, nuk janë kryer nga shoqëria dhe ankuesi i ka kryer vetë.

22.4. Në kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 26.12.1012, është vendosur çmimi 4.000.000 lekë, aq sa është edhe vlera reale e tij sipas çmimit të dakordësuar, por në DPV-në e vitit 2012 ankuesi ka deklaruar se nuk ka likuiduar shumën prej 480.000 lekësh.

22.5. Detyrimi i ngelur ndaj shoqërisë është shlyer gjatë vitit 2013 dhe është pasqyruar në DPV-në e këtij viti, si dhe në deklaratën *vetting*.

22.6. Nga analiza e fakteve të pasqyruara në provat e administruara gjatë hetimit, të analizuara këto fakte në unitet midis tyre, rezulton tej çdo dyshimi të arsyeshëm se faktet e deklaruara nga subjekti në deklaratën *vetting* (vlera e apartamentit, vlera e paguar në shoqëri, vlera e punimeve të kryera dhe koha e kryerjes së tyre), janë tërësisht të vërteta.

23. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionet e Komisionit lidhur me burimet financiare të krijimit të kësaj pasurie, duke pretenduar se:

(i) *Në lidhje me dhurimin nga z. P. LL., vjehri i subjektit të rivlerësimit:*

- Ndonëse në deklaratën *vetting* nuk është shprehur në mënyrë eksplicite shuma e dhuruar nga vjehri, kjo shumë është deklaruar qartë në DPV-në e vitit 2005, si dhe gjatë hetimit administrativ. Shuma e dhuruar nga vjehri ka si burim të ardhurat e realizuara prej tij nga aktiviteti privat i regjistruar më datë 27.02.2003, i cili nga viti 2006 e në vijim ka pasur xhiro vjetore 2.100.000 lekë, për të cilat janë paguar rregullisht taksat vjetore.

- Të ardhurat e ligjshme të vjehrit të tij për periudhën 2003-2005, për të cilën nuk disponohet dokumentacion, vlerësuar në mënyrë alternative sipas xhiros së deklaruar në vitin 2006 dhe *marzhin e fitimit neto 70 – 80% të xhiros për shërbimet mekanike*, përlllogariten shumë më të larta se shuma e dhuruar, 300.000 lekë.

- Në llogarinë bankare të vjehrit të tij, është shënuar edhe emri i subjektit me qëllim që ta ndihmonte atë me pagesat mujore, megjithatë likuiditeti në këtë llogari ka pasur gjithmonë si burim të ardhurat e ligjshme të vjehrit dhe, për këtë arsye, nuk është kryer deklarimi i kësaj llogarie nga ana e tij.

- Shuma e transferuar nga llogaria bankare e përbashkët për shoqërinë “{***}” ShPK, në vlerën 526.275 lekë, përfaqëson vlerën e dhuruar nga vjehri dhe lekët e dhëna *cash* nga ankuesi, të krijuara nga diferenca e huasë së dhënë nga shtetasi F. A., ndërsa vjehri i tij nuk ka pasur asnjëherë marrëdhënie biznesi me shoqërinë “{***}” ShPK.

(ii) Në lidhje me huanë e marrë nga z. F. A.:

- Në lidhje me konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit dështoi të provonte se huaja e marrë nga z. F. A. e kishte burimin nga të ardhurat e përfituara nga shitja e aksioneve në shumën 165.000 USD, qëndrimi i tij në seancë dhe në parashtrimet ndaj rezultateve të hetimit është në përputhje me kontratën përkatëse të huasë, ku huadhënësi është identifikuar si individ dhe jo si përfaqësues i shoqërisë “{***}” ShPK, deklaratimet e tij në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI më datë 28.01.2016, përshkrimin e bërë në deklaratën *vetting*, si dhe provat e paraqitura për burimin e këtyre të ardhurave.

- Në lidhje me këtë pikë, gjatë procesit administrativ (por jo në plotësimin e deklaratës *vetting*), në një moment konfuzioni për shkak të kohës së largët të kaluar, ankuesi nuk ka qenë i saktë, por kjo pasaktësi nuk zbeh vërtetësinë e fakteve që rezultojnë nga analiza e dokumenteve dhe provave të paraqitura gjatë procesit administrativ. Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të institucioneve të rivlerësimit, kjo pasaktësi e kryer në një moment nga ankuesi, nuk mund të shërbejë si shkak për dhënien e masës disiplinore, për sa kohë në përgjigje të barrës së provës, ai e ka saktësuar burimin e huasë, ashtu siç është e deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në kontratën e huasë.

- Ka paraqitur dokumentacion mbi të ardhurat e ligjshme të huadhënësit të përfituara nga shitja e 50% të aksioneve në një shoqëri me vlerë 165.000 USD, më datë 14.11.2000, të ardhura të cilat, sipas ankuesit, bazuar në ligjin e kohës, nuk ishin të ardhura të tatueshme.

(iii) Në lidhje me huanë e marrë nga z. K. D.:

Huaja prej 1.000.000 lekësh që ortaku i shoqërisë “{***}” ShPK, njëkohësisht dhe administrator i saj, z. K. D., i ka dhënë subjektit të rivlerësimit, justifikohet nga mjetet e lira dhe të disponueshme financiare që shoqëria ka pasur gjatë vitit 2005, të cilat janë tërhequr nga ana e ortakut si detyrim dhe jo si ndarje dividendi. Referuar të dhënave nga DRT Vlorë, rezultojnë se z. K. D., i cili figuron i regjistruar si administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, me NIPT {***}, ka deklaruar të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit për çdo vit dhe për vitin 2005, nga pasqyra financiare rezultojnë se ortaku i shoqërisë, njëkohësisht edhe administratori i saj, kryen të gjitha veprimet që shoqëria bën për blerje, shitje dhe arketime. Të drejtat dhe detyrimet midis tij dhe shoqërisë kontabilizohen në llogarinë {***}, “Llogaria e pronarit”, ose thënë ndryshe nga gjendja e mjeteve të përdorura nga xhepi i pronarit. Kjo llogari, në fund të periudhës, datë 31.12.2005, është në gjendjen debitore në vlerën 1.906.576 lekë, që do të thotë se pronari i shoqërisë i detyrohet shoqërisë shumën prej 1.906.576 lekësh, për shkak se kjo llogari ka të bëjë me kontribute të pronarit në shoqëri ose pagesa në *cash*, ajo konsiderohet si arka e pronarit. Të dhënat e shoqërisë janë lexuar nga eksperti kontabël, i cili zotëron licencën

e audituesit ligjor, për më tepër që në rastin konkret huaja është vërtetuar edhe sipas transfertës bankare.

24. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim edhe disa zëra të analizës financiare në lidhje me pagimin e këstit të parë të apartamentit, paguar më datë 27.09.2005, duke pretenduar se duhet të përfshihen huatë e marra nga shtetasit F. A. dhe K. D., të ardhurat neto nga paga për 9 muaj gjatë vitit 2005, në shumën 734.136 lekë, si dhe gjithë shuma *cash* e deklaruar pas ndryshimeve në DPV-në e vitit 2004. Në këtë analizë nuk duhet të përfshihen shpenzimet për qiranë në vitin 2005, pasi për periudhën shtator 2004 deri në vitin 2007, ankuesi ka jetuar në banesën e vjehrrit dhe gjithashtu duhet të ulen shpenzimet e udhëtimit në masën 98.064 lekë. Bazuar në këto pretendime, analiza financiare rezulton me balancë pozitive, në vlerën 183.313 lekë.
25. Subjekti pretendon se në fund të vitit 2005, detyrimi ndaj shoqërisë “{***}” ShPK ka qenë në shumën 579.100 lekë, ndërsa detyrimi për punimet e pakryera duhet të konsiderohet të paktën 200.000 lekë. Punimet e kryera prej ankuesit, në shumën 420.900 lekë, nuk mund të jenë kryer të gjitha në vitin 2005 dhe se në këtë vit janë kryer disa punime me vlerë sipas fletëdaljeve të dorëzuara në cilësinë e provës. Arsyeja që nuk janë deklaruar punimet, është se nuk kanë qenë objekt deklarimi në ato vite sipas ligjit nr. 9049/2003. Në konsideratë të sa më sipër, në vitin 2005 ankuesi ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për përballimin e punimeve të kryera, si dhe për pagesën e apartamentit.
26. Gjithashtu, ankuesi pretendon se detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën 480.000 lekë, është shlyer në vitin 2013, vërtetuar sipas mandatit të lëshuar nga shoqëria e ndërtimit që i është bashkëlidhur DIPP-2013, si dhe deklaratës *vetting*. Në DPV-në e vitit 2012, është deklaruar me vërtetësi se ende nuk ishte kryer pagesa e detyrimit të mbetur, pavarësisht se në kontratën e shitjes së vitit 2012, lidhur me pagimin e çmimit, ishte vendosur togfjalëshi: [...] në vlerën 4.000.000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale pa asnjë pretendim nga palët kontraktuese [...], pasi ai ishte vendosur në kontratë në mirëbesim reciprok midis palëve. Nëse në analizën financiare të vitit 2012 nuk përfshihet pagesa e këstit të fundit të çmimit të apartamentit në shumën 579.100 lekë, si dhe duke ripërlllogaritur shpenzimet e udhëtimit, atëherë analiza financiare rezulton pozitive.
27. Trupi gjykues, lidhur me këtë shkak ankimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit të Komisionit në raport me vendimin objekt kontrolli, konstaton dhe vlerëson si më poshtë.
28. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Kam prenotuar në vitin 2005 një apartament 2+1, në Vlorë. Kontrata e porosisë është përpiluar te zyra e shoqërisë. Më janë zbritur nga shuma shpenzimet që kam kryer vetë. Për blerjen e banesës, kam paguar në tetor të vitit 2005, në BKT, shumën 3.000.000 lekë, pjesën tjetër në vitin 2013. Te shuma 3.000.000 lekë, 1.000.000 lekë i kam pasur vetë nga kursimet e mia dhe nga ndihma e familjarëve, ndërsa 2.000.000 lekë i kam marrë hua me kontrata noteriale. Kontrata përfundimtare e banesës është bërë në vitin 2012 te noteri. Banesa është regjistruar në ZVRPP. Vlera e pasurisë: 4.000.000 lekë. Kontratë porosie 2005. Kontratë noteriale, datë 26.12.2012.*

29. Kjo pasuri, për herë të parë është deklaruar në DIPP-në 2005, ku subjekti ka deklaruar: *Një shtëpi banimi me sip. 106 m², e blerë nga firma e ndërtimit “{***}”, në pallatin 9-katësh që po ndërton në rrugën “{***}” të qytetit të Vlorës. E kam blerë në shumën 4.000.000 lekë. Nga kjo shumë më janë zbritur disa punime që do t'i bëj vetë dhe që kapin vlerën 420.900 lekë. Pasuria nuk është e regjistruar, por kam bërë thjesht një kontratë porosie pa noter. Pronarit i kam dhënë 3.000.000 lekë dhe i kam mbetur dhe 579.100 lekë. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar: *Përdorimi i cash-it në shtëpi në shumën 400.000 lekë. Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë e fizikë”, subjekti ka deklaruar: [...] I detyrohem firmës së ndërtimit shumën 579.100 lekë për shkak të blerjes së banesës.**
30. Në DIPP-2012, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar: *I detyrohem firmës së ndërtimit për banesën që kam blerë në Vlorë, shumën 480.000 lekë. Firma më ka pajisur me certifikatë këtë vit, por unë nuk e kam likuiduar akoma, meqenëse firma ka bërë përlllogaritjet përfundimtare dhe më ka zbritur nga detyrimi shumën prej 100.000 lekësh për disa punime që nuk m'i ka kryer.*
31. Në DIPP-2013, subjekti ka deklaruar pagesën e këstit prej 480.000 lekësh dhe bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti ka paraqitur një mandatarkëtimin nr. {***}, datë 19.10.2013, për pagesën pranë shoqërisë “{***}” ShPK, të këstit prej 480.000 lekësh.
32. Në kontratën e porosisë, datë 27.9.2005 (shkresë e thjeshtë), hartuar pranë shoqërisë “{***}” ShPK, palët kanë dakordësuar shitjen e një apartamenti banimi 2+1, në katin e dytë në drejtimin juglindje, por pa përcaktuar sipërfaqen e apartamentit, vlerën e porosisë/blerjes së tij, si dhe këstet e pagesës së çmimit të blerjes. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *vetting*, veprimin bankar pranë BKT-së, datë 27.9.2005, transfertë ndërmjet llogarive, përfituese shoqëria “{***}” ShPK, e shumës prej 3.000.000 lekësh, me përshkrimin: “Dritan Marku sa kalon për “{***}” detyrim për blerje shtëpie”.
33. Sipas kontratës së shitjes të nënshkruar në datën 26.12.2012, me palë shitëse shoqërinë “{***}” ShPK dhe blerës subjektin e rivlerësimit, me objekt kalimin e pronësisë së apartamentit të banimit me sip. 103,07 m², në Vlorë, parashikohet se: *[...] palët kanë rënë dakord që apartamenti sa më sipër të blihet në vlerën 4.000.000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale pa asnjë pretendim nga palët kontraktuese [...].*
34. Referuar të dhënave të përcjella nga ILDKPKI-ja, rezulton se subjekti, në dokumentacionin shpjegues të dorëzuar sipas procesverbalit të mbajtur në datën 28.1.2016 në këtë institucion, ka depozituar një procesverbal të shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, ku përshkruhen punimet që do të kryheshin prej tij me vlerë 420.900 lekë dhe do të zbriteshin nga vlera totale e apartamentit.
35. Gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni e ka ftuar subjektin të japë shpjegime lidhur me mosdeklarimin në deklaratën *vetting*, të vlerës së shpenzimeve të kryera në apartamentin me sip. 103,07 m², që deklarohet se janë zbritur nga vlera totale prej 4.000.000 lekësh, duke i kërkuar, gjithashtu, të provojë me dokumentacion ligjor, kohën dhe vlerën e këtyre shpenzimeve, si dhe zbritjet e përfituara në çmimin e apartamentit. Në përgjigje

të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se: [...] këto punime janë kryer periodikisht në vitet 2005 - 2007, pra, për një periudhë prej 3-vjetësh. Sa i përket shumës së shpenzimeve për punimet që kam kryer, me sa mbaj mend, nuk e ka kaluar shumën që më ka zbritur firma [...]. Për të justifikuar këtë fakt, subjekti ka paraqitur disa fletëdalje për periudhën 2005 – 2006, të pretenduara nga shoqëria “{***}” ShPK, Vlorë si dhe dy procesverbale të firmës ndërtuese, ku pasqyrohen zërat e punimeve dhe shumat respektive prej 420.900 lekësh dhe 98.530 lekësh, depozituar prej tij në cilësinë e provës. Subjekti nuk ka pasqyruar në DIPP-të 2005-2007 asnjë të dhënë për shpenzimet e pretenduara si të kryera prej tij.

36. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit për sa duket se subjekti i rivlerësimit nuk provon:

i. aftësinë e personave të tjerë të lidhur, K. D. dhe F. A., që me të ardhura nga burime të ligjshme, që në vitin 2005 t'i japin subjektit të rivlerësimit hua prej 2.000.000 lekësh (1.000.000 lekë secili);

ii. pagesën në datën 27.9.2005, dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2005 - 27.9.2005, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën (-) 2.356.794 lekë⁷;

iii. investimet, pagesat dhe shpenzimet e kryera për të gjithë vitin 2005, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën (-) 2.270.295 lekë;

iv. mospërputhjet mbi shumat e paguara/investuara për këtë pasuri, vlerën e punimeve, zbritjet nga vlera totale e apartamentit;

v. mospërputhjet mbi kohën e pagesës së këstit të dytë të çmimit të blerjes, prej 480.000 lekësh.

37. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, pasi ka shqyrtuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigjet ndaj rezultateve të hetimit dhe provat bashkëlidhur tyre, si dhe pasi ka kryer seancën dëgjimore, ka dhënë vendimin objekt kontrolli. Në arsyetimin e vendimit, Komisioni, konkluzionin mbi pasaktësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, ua atribuon mospërputhjeve të konstatuara mes deklarimeve të subjektit me përmbajtjen e kontratës së shitblerjes lidhur me vlerën dhe kohën e kryerjes së pagesave për apartamentin, si dhe faktit që subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të dokumentojë në kohë dhe në vlerë shpenzimet e pretenduara si të kryera prej tij për punimet, vlera e të cilave pretendohet të jetë zbritur nga çmimi i kontratës, situatë e cila është vlerësuar se e vendos subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë. Në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, palët kanë deklaruar para noterit se vlera e paguar në favor të shoqërisë ndërtuese është 4.000.000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës noteriale pa asnjë pretendim mes palëve, ndërkohë që në deklaratën vetting subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera e apartamentit është 4.000.000

⁷ Në analizën financiare të pasqyruar në rezultatet e hetimit administrativ Komisioni fillimisht sikurse ka arsyetuar në paragrafin 36 të vendimit e ka përfshirë si burim të ligjshëm dhuratën e pretenduar nga subjekti në shumën 300.000 lekë, por në përfundim të procesit në paragrafin 84 të vendimit duket se nuk e ka konsideruar atë si një burim financiar të ligjshëm.

lekë sipas kontratës së porosisë së vitit 2005 dhe kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2012. Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar se ka paguar në tetor të vitit 2005, nëpërmjet transfertës bankare në BKT, shumën 3.000.000 lekë, ndërsa pjesën tjetër deklaroi se e ka paguar në vitin 2013. Në DIPP-në e vitit 2012, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar se: *I detyrohem firmës së ndërtimit për banesën që kam blerë në Vlorë, shumën 480.000 lekë. Firma më ka pajisur me certifikatë këtë vit, por unë nuk e kam likuiduar akoma, meqenëse firma ka bërë përlllogaritjet përfundimtare, ka zbritur nga detyrimi shumën prej 100.000 lekësh për disa punime që nuk më i ka kryer.* Ndërkohë që, referuar DIPP-2013, rezultoi se subjekti ka deklaruar se pas lidhjes së kontratës së shitblerjes dhe pajisjes me certifikatë pronësie, ka kryer pagesën e detyrimit të mbetur për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 480.000 lekë. Referuar këtyre deklarimeve, çmimi i paguar nga subjekti pretendohet të jetë 3.480.000 lekë, ndërkohë që vlera e apartamentit deklarohet të jetë 4.000.000 lekë. Sa më sipër, nuk rezultoi që subjekti të ketë deklaruar shlyerjen e plotë të vlerës së kësaj pasurie sipas kontratës së shitjes në deklaratën *vetting*. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, në cilësinë e dokumentit justifikues për pagimin e kështit të dytë, subjekti ka depozituar mandatpagesën nr. {***}, datë 19.10.2013, me vlerë 480.000 lekë⁸. Nga sa evidentuar më sipër, konstatimi i Komisionit se faktet e pretenduara nga subjekti lidhur me zbritjet e referuara të çmimit për punime të kryera prej tij, apo pagesën e kështit të fundit, bien ndesh me përcaktimet e bëra nga palët në kontratën e shitblerjes, është i saktë.

38. Trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike vjetore të viteve 2005 dhe 2012, ka deklaruar zbritje të çmimit të apartamentit për punime të kryera prej tij. Komisioni ka verifikuar pretendimet e subjektit lidhur me zbritjet e referuara për punime të kryera prej tij, duke konstatuar se ato nuk provohen dhe janë në kundërshtim me kontratën e shitjes së apartamentit. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ, në raport me pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit në Komision, si dhe në ankim, trupi gjykues konstaton se, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-të 2005 dhe 2012 zbritje të çmimit për disa punime në vlerat 420.900 lekë dhe 98.530 lekë, si dhe është deklaruar prej tij në vijimësi detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë, një fakt i tillë nuk rezultoi të jetë pasqyruar në kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2012, dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën dhe kohën e saktë të kryerjes së punimeve, të cilat pretendohet të jenë zbritur nga çmimi i apartamentit, dhe dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ⁹, nuk provon vlerën e punimeve

⁸Ky dokument rezultoi të jetë depozituar edhe pranë ILDKPKI-së, sipas procesverbalit të datës 28.01.2016.

⁹Fletëdaljet e depozituara në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, për periudhën 2005 – 2006, të pretenduara nga shoqëria “{***}” ShPK, Vlorë, nëpërmjet të cilave pretendohet të provohet vlera e punimeve të kryera prej tij, nuk përcaktojnë personin juridik apo fizik, i cili ka i lëshuar ato, pasi vetëm dy prej tyre mbajnë emrin e shoqërisë, por jo vulën e saj. Ato nuk kanë formën apo elementet e një fature pasi nuk kanë numër rendor dhe vetëm njëra prej tyre mban nr. {***}, datë 7.2.05, datat e tjera fillojnë nga 26.11.2005 deri tek e fundit 6.4.2006. Këto fletëdalje nuk përcaktojnë vlerë punimesh, por elemente të sasisë, çmimit dhe vlerës totale të blerjes së mallrave të ndryshme dhe nuk mund të përcaktohet koha dhe vlera totale e tyre. Dy procesverbalet e paraqitura nga subjekti në lidhje me zbritjen e shumës 420.900 lekë dhe një tjetër për zbritjen e shumës 98.530 lekë, nuk përmbajnë datë, firmën e administratorit të shoqërisë që, sipas subjektit, ka autorizuar zbritjet apo vulën e saj. Këto procesverbale

të kryera nga subjekti i rivlerësimit, si vlera korresponduese e uljes së çmimit të apartamentit në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

39. Lidhur me pretendimin e subjektit se detyrimi financiar i mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit është deklaruar çdo vit dhe se ligji i kohës nuk kërkonte deklarimin e shpenzimeve të kryera prej tij për punimet dhe, për rrjedhojë, mosdeklarimi i këtyre shpenzimeve nuk mund të përbëjë shkak për dhënien e masës disiplinore, trupi gjykues konstatoi se, me deklarimin e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë, subjekti ka përmbushur detyrimin e parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, sipas të cilit: *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, detyrimet financiare si më poshtë: [...] dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj [...].* Por, subjekti nuk ka qenë i qartë dhe bindës gjatë procesit në Komision lidhur me punimet që pretendon se i ka kryer vetë, kohën e kryerjes së tyre dhe vlerën e shpenzuar për këto punime. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se *faktet e parashtruara nga subjekti, me zbritjet e referuara për punime të kryera apo për pagesën e kësaj të fundit, pas lidhjes së kësaj kontrate, nuk provohen dhe janë në kundërshtim me kontratën e firmosur nga vetë palët.*
40. Në vijim, trupi gjykues analizoi pretendimet e ankuesit lidhur me burimet financiare të krijimit të kësaj pasurie. Rezulton se Komisioni, në paragrafët 90 dhe 91 të vendimit, ka konkluduar se: *Deklarimi i subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, qëndrimi i tij në drejtim të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të përcjellë, i krijuan bindjen trupit gjykues se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pasaktë, për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore, lidhur me krijimin e kësaj pasurie. Komisioni, referuar vendimit nr. 11 (JR), datë 3.7.2020, të Kolegjit, ka vlerësuar se e ka të pamundur të dallojë se cili deklarim është i vërtetë dhe cili ka qenë shkak i vërtetë që e ka detyruar subjektin e rivlerësimit për të mos respektuar kërkesat urdhëruese të ligjit për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimin e krijimit. Në këtë konkluzion, Komisioni ka arritur pasi, përveç pasaktësisë në deklarime, ka konstatuar edhe problematika në kontrollin e secilit burim krijimi të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, analizuar si vijon.*
41. Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave nga ndihma e familjarëve, të deklaruar si burim për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi, Komisioni, pasi ka konstatuar kompleksitetin e transaksioneve për transfertën e shumës prej 526.275 lekësh nga llogaria e përbashkët bankare e subjektit me vjehrrin e tij, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendon se kishte si burim edhe shumën 300.000 lekë të dhuruar nga vjehri i tij, ka vlerësuar se: *Lidhur me burimin e të ardhurave të vlerave monetare 400.000 lekë që vjehri i subjektit depozitoi cash në llogarinë e përbashkët me subjektin, ky depozitim nuk provon pronësinë e fondeve dhe burimin e transfertës prej 526.275 lekësh, apo destinacionin e transaksionit të kryer nga kjo llogari për shoqërinë “{***}” ShPK, me përshkrim “Për F. SH., detyrim”.*

rezultojnë të firmosura nga ing. E. A., i cili, referuar shkresës nr. {***} prot., datë 10.06.2021, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë, nuk rezulton që të ketë qenë i punësuar pranë shoqërisë “{***}” ShPK.

42. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi se:

42.1. Subjekti, në deklaratën *vetting*, nuk e ka deklaruar vlerën e shumës së përfituar nga ndihma e familjarëve, personin dhurues, si edhe dokumentacionin justifikues ligjor lidhur me burimet e krijimit të shumës së dhuruar. Këtë dhurim, subjekti e ka deklaruar vetëm në DIPP-2005¹⁰, ku ka deklaruar: *Familjes sime i është dhuruar një shumë prej 300.000 lekësh nga shtetasi P. LL., i cili është babai i bashkëshortes (vjeherri). Kjo shumë është dhuruar me rastin e blerjes së banesës.*

42.2. Lidhur me arsyen e mosdeklarimit të shumës së përfituar nga familjarët dhe burimin e krijimit të kësaj shume në deklaratën *vetting*, në përgjigje të pyetësorit nr. 2¹¹, subjekti ka shpjeguar se kjo përbën një veprim të pakujdesshëm nga ana e tij. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume, subjekti ka sqaruar se vjeherri i tij së bashku me bashkëshorten kanë qenë vazhdimisht në marrëdhënie të rregullta pune deri në daljen në pension dhe shuma që i është dhuruar subjektit, vjen si rezultat i kursimeve të tyre për të gjithë periudhën, duke filluar që në vitin 1991, fakt i cili vërtetohet nga librezat e kursimit. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur dokumentin e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për vitet e sigurimit për shtetasin P. LL., si dhe shkresën “Kthim përgjigje” nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për shtetasen L. LL. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, si edhe në ankim, subjekti ka deklaruar se shuma e dhuruar nga vjeherri i tij ka si burim të ligjshëm të ardhurat e realizuara prej tij nga aktiviteti privat, i regjistruar në datën 27.02.2003, me NIPT {***}¹².

42.3. Nga informacioni i përcjellë nga BKT-ja¹³, rezulton se vjeherri i subjektit ka pasur dy llogari të përbashkëta me subjektin (P. LL. ose Dritan Marku), një llogari në lekë me nr. {***}, të hapur në datën 01.12.2004 dhe të mbyllur në datën 09.10.2007, si edhe një llogari në euro me nr. {***}, të hapur në datën 01.03.2007 dhe të mbyllur në datën 11.05.2009. Këto llogari nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratimet periodike vjetore.

42.4. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në llogarinë bankare të vjeherrit, është shënuar edhe emri i tij, me qëllim që ta ndihmonte për pagesat mujore (sigurime, taksa), pasi ai ishte person fizik dhe duhet të deklaronte çdo muaj. [...] *Paratë në këtë llogari bankare kanë pasur gjithmonë si burim të ardhurat e ligjshme të vjeherrit, prandaj nuk është kryer deklarimi i kësaj llogarie nga subjekti, për shkak se paratë në këto llogari bankare, nuk kanë qenë të tijat. [...] Shuma e transferuar për shoqërinë “{***}” ShPK, në shumën 526.275 lekë, përfaqëson vlerën e dhuruar nga vjeherri dhe lekët e dhëna cash nga mua të krijuara nga diferenca e dhënë nga shtetasi F. A., pasi 800.000 lekë m'i kishte dërguar me bankë te shoqëria “{***}” ShPK dhe 200.000 lekë m'i ka dhënë mua dorazi. Shuma*

¹⁰ Në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale”.

¹¹ E-mail i datës 12.02.2021.

¹² Referuar ekstraktit¹² të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “person fizik”, datë 27.01.2021, rezulton se shtetasi P. LL. është regjistruar në datën 27.02.2003, me NIPT {***}, me objekt të aktivitetit “Shërbime të ndryshme mekanike”, në lagjen “{***}”, Vlorë. Për periudhën 2003 – 2005, DRT Vlorë ka informuar se nuk disponon dokumentacion për pagesat e kryera në këtë periudhë. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion në lidhje me të ardhurat e përfituara nga vjeherri i tij nga aktiviteti i regjistruar për periudhën 2003 – 2009.

¹³ Shkresë e ardhur nga BKT-ja, me nr. {***}, datë 30.12.2019.

200.000 lekë që unë ia kam dhënë vjehrrit në cash, mbasi ai kishte transferuar shumën 526.275 lekë në llogarinë e SH.. Shuma 526.275 lekë nuk është shlyerje detyrimi ndaj SH., por është transferim i lekëve të dhuruara dhe atyre të dhëna dorazi nga ana ime, në shumën 200.000 lekë. Shënimi në bankë është pakujdesi e punonjësës së bankës dhe vjehrrit. Ky i fundit nuk ka pasur asnjëherë ndonjë marrëdhënie biznesi me shoqërinë “{***}”.

42.5. Nga aktet e çështjes, rezulton se në llogarinë bankare dyemërore në lekë të subjektit dhe vjehrrit të tij¹⁴, në datën 01.12.2004 është depozituar *cash*, shuma 400.000 lekë, nga shtetasi P. LL., dhe në datën 02.12.2004 e gjithë shuma është kaluar në depozitë me afat deri në datën 07.06.2005, ku është debituar me transfertë bankare shuma prej 300.000 lekësh, me përshkrimin: “Sa kalim detyrimi”. Urdhëruesi dhe përfituesi i transfertës nuk është e mundur të identifikohen. Pjesa e mbetur prej 107.795 lekësh është kaluar në depozitë me afat. Në datën 28.06.2005, llogaria është kredituar nëpërmjet një transferte bankare me vlerë 415.000 lekë, me përshkrim: “Shashica sa kalon detyrim”. Nga verifikimi i llogarive bankare¹⁵ të shoqërisë “{***}” ShPK në BKT, të depozituara nga subjekti me përgjigjet e rezultateve të hetimit¹⁶, konfirmohet se kjo transfertë është urdhëruar nga “{***}” ShPK. E gjithë shuma e akumuluar në llogari, prej 522.795 lekësh, është kaluar në depozitë me afat në të njëjtën datë (28.06.2005). Në datën 27.09.2005, e gjithë vlera e depozitës së maturuar bashkë me interesat është transferuar te shoqëria “{***}” ShPK me përshkrimin: “P. LL. sa kalon për F. SH., detyrim”. Nga shuma e depozituar *cash* prej 400.000 lekësh, nga vjehri i subjektit, z. P. LL., vetëm shuma prej 107.795 lekësh ka shërbyer si burim krijimi i shumës 526.275 lekë. Në këtë situatë faktike, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vjehri i tij i ka dhuruar familjes së tij shumën 300.000 lekë, mbetet i paprovuar. Pretendimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit pas rezultateve të hetimit në lidhje me transaksionet dhe ndërveprimet mes tij, vjehrrit, shoqërive tregtare “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe administratorëve të këtyre shoqërive, nuk japin qartësi për llojin e marrëdhënies dhe detyrimeve që mund të kenë ekzistuar mes tyre¹⁷.

42.6. Por, edhe duke abstraguar nga konkluzioni i mësipërm, sa i përket përkatësisë së fondeve në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe vjehrrit të tij, si dhe destinacionit të transfertës së realizuar më datë 27.09.2005, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me të ardhurat

¹⁴ Subjekti ka pretenduar se kjo llogari bankare është hapur për të ndihmuar z. LL. për kryerjen e pagesave të sigurimeve dhe taksave, por, nga kontrolli i saj, rezulton se nga kjo llogari nuk është kryer ndonjë veprim nga subjekti i rivlerësimit apo edhe nga z. LL., lidhur me pagesat e sigurimeve dhe taksave.

¹⁵ Llogaria nr. {***} në lekë, në BKT.

¹⁶ E-mail i datës 25.06.2021.

¹⁷ Nga kontrolli i dokumentacionit në dosje dhe nga kontrolli i llogarive të shoqërisë “{***}” ShPK, të paraqitura në cilësinë e provës nga subjekti, me përgjigjet e rezultateve të hetimit, rezultoi se kjo shoqëri ka disa llogari bankare të hapura në BKT. Në llogarinë në lekë me nr. {***}, në datën 27.09.2005, gjendja fillestare ka qenë 3.633.965 lekë dhe, gjatë ditës, janë kryer veprimet: (i) kreditim nëpërmjet transfertës bankare në shumën 800.000 lekë, me përshkrimin: “{***} sa kalon për F. SH., detyrim lik. fat.”; (ii) kreditim nëpërmjet transfertës bankare në shumën 526.275 lekë, me përshkrimin: “P. LL. sa kalon për F. SH., detyrim”; (iii) debitim në shumën 3.000.000 lekë, me përshkrimin “Dritan Marku sa kalon për {***}, detyrim për blerje shtëpie”.

nga aktiviteti privat¹⁸ i vjehrrit të tij, nuk vërteton mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur për krijimin e shumës 300.000 lekë dhe, për rrjedhojë, të ardhurat e pretenduara si dhuratë nga vjehri, nuk mund të përfshihen në burimet e ligjshme në analizën financiare të kësaj pasurie.

43. Lidhur me pretendimin e ankuesit se është i gabuar konkluzioni i Komisionit lidhur me burimin e deklaruar nga huaja në shumën 1.000.000 lekë, nga z. F. A., trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e fashikullit të Komisionit, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

43.1. Pas kontrollit të kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për huadhënien në shumën 1.000.000 lekë, nga shtetasi F. A., Komisioni ka arsyetuar në vendim se¹⁹:

- Lidhur me burimin e të ardhurave të huadhënësit F. A., subjekti, në deklaratet e tij në deklarimet vetting, ka deklaruar se ato e kanë burimin nga të ardhurat e tij si person fizik, në përgjigje të pyetësorëve ka deklaruar se ato e kanë burimin nga të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë tregtare “{***}” ShPK, duke pretenduar se nuk ka pasur detyrim ligjor mbi shpërndarjen e dividendit, ndërsa pas dërgimit të barrës së provës, ka paraqitur dokumentacionin bankar ku provohet se kjo shoqëri, në datën 27.9.2005, ka kaluar vlerën prej 800.000 lekësh për firmën “{***}” ShPK, dhe ka deklaruar se burimi i të ardhurave është shitja e aksioneve në datën 14.11.2000 nga shoqëria “{***}”, kundrejt shumës 165.000 USD.
- Nga analiza e dokumentacionit bankar, ku provohet se kjo shoqëri në datën 27.9.2005, ka kaluar vlerën prej 800.000 lekësh për firmën “{***}” ShPK, rezulton se jo vetëm data dhe vlera e transfertës nuk përkojnë me datën dhe vlerën e deklaruar të huasë, por dhe përshkrimi i transfertës si detyrim likuidim fature, nuk mbështet deklaratet e subjektit.
- Deklarimi i subjektit se burimi i të ardhurave është shitja e aksioneve në datën 14.11.2000, nga shoqëria “{***}”, kundrejt shumës 165.000 USD, nuk shoqërohet me të dhëna për pjesën takuese mbi të ardhurat e përfituara nga huadhënësi, dhe as me prova nga organet tatimore, lidhur me pagesën e tatimeve për të ardhurat.
- Mënyra e përfitimit/transaksioni i kryer për pjesën takuese mbi të ardhurat e përfituara nga huadhënësi, nuk rezultoi i provuar në ndonjë formë. Trupi gjykues vlerëson si të rëndësishme ekzistencën e një lidhjeje midis shumës së përfutuar në formë huaje në vitin 2005 dhe burimit të deklaruar nga subjekti rivlerësimit. Duke qenë se procesi i rivlerësimit i ngarkon subjektet me përgjegjësi për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të

¹⁸ Shkresa nr. {***} prot., datë 21.06.2021, nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Vlorë, informon se për vitet 2003-2006 nuk disponohet asnjë e dhënë, ndërkohë që pasqyron të dhëna mbi xhiron e vlerësuar për vitet 2007-2010, për të cilat konfirmohet edhe pagesa e detyrimeve tatimore. Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 18.06.2021, informon se tatimpaguesi P. LL. me NIPT {***}, me veprimtari “Shërbime të ndryshme mekanike”, në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitur për vitet 2010 e në vijim, ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve, por nuk paraqet asnjë të dhënë për vitet 2003 deri 2005, kur pretendohet shuma e dhuruar.

¹⁹ Paragrafi 87, faqja 10 e vendimit të Komisionit.

përdorura për krijimin e pasurive, subjekti i rivlerësimit, në këtë rast, dështoi të bindte trupin gjyqës se kjo hua e kishte burimin pikërisht nga këto të ardhura.

43.2. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për blerjen e apartamentit ka marrë hua 2.000.000 lekë me kontrata noteriale, por nuk deklaruar emrat e huadhënësve.

43.3. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar hua nga F. A., në shumën 1.000.000 lekë, sipas kontratës së huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.9.2005 dhe hua nga K. D., në shumën 1.000.000 lekë, sipas kontratës së huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.8.2005.

43.4. Me kontratën e huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.9.2005, huadhënësi F. A. i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit një shumë prej 1.000.000 lekësh, me interes 3%, me një afat 5-vjeçar. Sipas deklaratës noteriale “Për njohje detyrimi” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.06.2021, të huadhënësit F. A., huaja ka pasur si burim të ardhurat e tij personale, dhe se interesi prej 3% në vit do të aplikohet në rast të moskthimit të saj në kohë. Në deklaratimet periodike vjetore ndër vite, subjekti ka deklaruar vetëm shlyerjen e principalit dhe nuk ka deklaruar pagesa lidhur me interesat²⁰.

43.5. Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të pyetjes nr. 19 të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Kam marrë borxh në vitin 2005, prej shtetasve F. A. dhe K. D. nga 1.000.000 lekë secilit, me qëllim blerjen e banesës. Kam kontratat përkatëse të huasë. Dy personat kanë pasur aktivitet privat, me statusin e personit juridik. Bashkëlidhur kopje të kontratave të huasë, ekstrakte të nxjerra nga QKB-ja mbi aktivitetin e tyre, si dhe bilancet e firmës “{***}” ShPK, para vitit 2005. Për firmën “{***}” ShPK që i përket shtetasit F. A., nuk kam paraqitur bilance, pasi edhe vlera e kapitalit fillestar të regjistrimit të kësaj shoqërie, besoj se është e mjaftueshme.*

43.6. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, e ka ftuar subjektin të paraqesë dokumentacion ligjor lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve për shumat monetare të dhëna hua, të cilat janë deklaruar nga subjekti si burim për pagesën e kështit të parë të çmimit të blerjes/porositjes së apartamentit në datën 27.9.2005, duke specifikuar që ky dokumentacion duhet të përfshijë jo vetëm bilancet, por edhe të dhëna mbi ndarjen e dividendit nga shoqëritë tregtare në të cilat këta individë janë ortakë. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Siç rezulton edhe nga pyetësori, bëhet fjalë për një shumë prej 2.000.000 lekësh të marrë hua nga shtetasit K. D. dhe F. A. Këto shuma nuk janë dhënë si person fizik, por nga shoqëria tregtare të cilën zotëronin këta shtetas. Lidhur me*

²⁰ Subjekti rezulton të ketë deklaruar në DIPP-në e vitit 2006, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”: Shlyerje të shumës prej 600.000 lekësh nga detyrimi ndaj shtetasit K. D. (gjendje e detyrimit deri në 31 dhjetor, shuma 400.000 lekë) dhe shlyerje të shumës 100.000 lekë nga detyrimi ndaj shtetasit F. A., gjendje e detyrimit deri në 31 dhjetor, shuma 900.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2007, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar: “Shlyerje të detyrimit të mbetur në shumën 400.000 lekë ndaj shtetasit K. D. dhe shlyerje të shumës 300.000 lekë nga detyrimi ndaj shtetasit F. A. (gjendje e detyrimit deri në 31 dhjetor, shuma 600.000 lekë)”. Në DIPP-në e vitit 2008, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar shlyerje të detyrimit të mbetur në vlerën 600.000 lekë, ndaj shtetasit F. A.

ndarjen e dividendëve, subjekti ka sqaruar se: *Kam folur me të dy personat huadhënës dhe u kam kërkuar pasqyrimin e ndarjes së dividendëve për këto periudha. Nga këta kam marrë përgjigjen se veprimtaria e tyre është e organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ndaj nisur nga kjo formë organizimi, nuk mund të bëhej fjalë për ndarje dividendësh. Sipas tyre, ndarja e dividendëve u përket vetëm shoqërive aksionere. Gjithsesi, unë në momentin e marrjes së huasë nuk jam thelluar në këtë aspekt sepse kam gjykuar që kjo është një çështje e brendshme e tyre.*

43.7. Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë (në vijim “DRT Vlorë”), nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 21.08.2017, drejtuar ILDKPKI-së, ka bërë me dije se K. D. figuron i regjistruar si administrator i shoqërisë “{***}“ ShPK, me NIPT {***}, regjistruar në datën 18.7.2000. Shoqëria ka detyrime të papaguara në vlerën 6.200.034 lekë, si dhe se nuk janë deklaruar dividendë deri në vitin 2005.

43.8. DRT Vlorë, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 24.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së, ka informuar se F. A. figuron i regjistruar si administrator i subjektit “{***}” ShPK, me NIPT {***}, regjistruar në datën 2.10.2002 dhe që nga data 16.6.2010, ka kaluar në status pasiv. Kjo shoqëri ka pasur detyrime tatimore në shumën 98.096 lekë, si dhe ka deklaruar dividendë në vitin 2005, në shumën 292.860 lekë.

43.9. Në deklaratimet në ILDKPKI, në procesverbalin e datës 28.1.2016, subjekti ka deklaruar se ka marrë hua shumën 1.000.000 lekë nga shtetasi F. A. dhe shumën 1.000.000 lekë nga shtetasi K. D.

43.10. Me shpjegimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Pasi dakordësova porositjen e apartamentit në shoqërinë “{***}” ShPK, sipas marrëveshjes së bërë më parë me dy miqtë e mi, K. D. dhe F. A., për marrjen hua të shumës 1.000.000 lekë nga secili prej tyre, mblodha të gjitha lekët (hua-dhurim-kursimet e mia, i mblodhëm në llogarinë bankare të “{***}”). Shoqëria “{***}” ShPK kërkonte që pagesa të kryhej menjëherë, dhe në gëzim, apo nxitim e sipër për të blerë apartamentin, si i ri që sapo kishte krijuar familjen, mendova si mënyrën më të mirë, transferimin e shumës 3.000.000 lekë nga llogaria e shoqërisë “{***}”. Transferata u krye në BKT në datën 27.09.2005, me përshkrimin: “Dritan Marku sa kalon për “{***}”, detyrim për blerje shtëpie”. Me kontratën e datës 14.11.2000, shtetasi F. H. dhe F. A. i shesin aksionet e tyre shtetasit K. L. kundrejt shumës 165.000 USD. Ky fakt tregon se F. A. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të më dhënë hua shumën 1.000.000 lekë.*

44. Lidhur me pretendimin e ankuesit se si burim për huanë nga huadhënësi F. A. kanë shërbyer të ardhurat që ai ka realizuar nga shitja e aksioneve sipas kontratës së datës 14.11.2000, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e fashikullit të Komisionit, konstaton se kontrata e shitjes së aksioneve nr. {***} rep., datë 14.11.2000, nëpërmjet së cilës F. A. dhe F. H., si aksionerë të shoqërisë “{***}”, i shesin aksionet e tyre blerësit K. L., kundrejt shumës 165.000 USD, nuk pasqyron të dhëna mbi mënyrën se si është kryer pagesa, për pjesën takuese mbi të ardhurat e përfituara nga huadhënësi F. A., pasi kjo kontratë nuk është e shoqëruar me dokumentacionin ligjor të regjistrimit të shoqërisë aksionere në Shqipëri apo në një shtet tjetër,

sipas të cilit duhej të provohej se cilët kanë qenë aksioneret e saj, pronësinë dhe numrin e aksioneve të zotëruara nga shtetasi F. A., si dhe nuk ka të dhëna mbi depozitimimin e kësaj kontrate pranë organeve kompetente. Për më tepër, trupi gjykues konstaton se, nga koha e shitjes së këtyre aksioneve në vitin 2000, deri në kohën e dhënies së huasë subjektit të rivlerësimit, ka kaluar një kohë e konsiderueshme, gjatë së cilës nuk ka ndonjë gjurmë që këto të ardhura janë disponuar nga huadhënësi në vitin 2005 dhe nëse kanë shërbyer si burim për huanë e dhënë subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit, në këtë rast, dështoi të bindte trupin gjykues se kjo hua e kishte burimin pikërisht nga këto të ardhura.*

45. Rezulton se shoqëria “{***}” ShPK, me administrator F. A., në datën 27.9.2005, ka kaluar vlerën prej 800.000 lekësh për shoqërinë “{***}” ShPK, me përshkrimin: “{***} sa kalon për f. SH., detyrim, lik. fat.”. Në lidhje me këtë transfertë bankare, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shtetasi F. A., nga shuma e huasë prej 1.000.000 lekësh, shumën prej 800.000 lekësh ia kishte dërguar nëpërmjet bankës shoqërisë “{***}” ShPK, ndërsa 200.000 lekë ia ka dhënë dorazi. Në lidhje me sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, përpos faktit se vlera e transfertës nga shoqëria “{***}” ShPK, më datë 27.09.2005, drejt shoqërisë “{***}” ShPK, mban përshkrimin: “*Detyrim, lik. fat.*”, të dhënat e mësipërme dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit pas njohjes me rezultatet e hetimit, japin informacion të ndryshëm sa i takon datës dhe shumës së huasë²¹ nga shtetasi F. A., pasi janë në mospërputhje me përmbajtjen e kontratës së huasë të datës 22.09.2005. Bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për moskonsiderimin e kësaj huaje si burim financiar i ligjshëm për blerjen e pasurisë objekt kontrolli dhe pasi subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur, z. F. A., nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar burimin e ligjshëm të huasë në shumën 1.000.000 lekë.
46. Lidhur me pretendimin e ankuesit se është i gabuar konkluzioni i Komisionit lidhur me burimin e deklaruar nga huaja në shumën 1.000.000 lekë nga z. K. D., trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e fashikullit të Komisionit, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
47. Lidhur me burimin e të ardhurave të huadhënësit K. D., Komisioni ka vlerësuar²² se: *deklarimet nuk mbështeten në dokumentacionin dhe provat e administruara në dosje, pasi, referuar të dhënave të paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorit, “llogaritë vjetore (gjendje financiare) për periudhën 1.1.2005 – 31.12.2005, të shoqërisë “{***}” ShPK, rezulton se vlera prej 1.906.576 lekësh, është gjendja e likuiditeteve (para në dorë) në arkën e shoqërisë në datën 31.12.2005 dhe jo të drejta /detyrime të ortakut, si u pretendua nga subjekti në shpjegimet pas rezultateve të hetimit dhe audituesi ligjor i tij. Nëse pronari/ortaku ka pasur detyrime financiare ndaj shoqërisë në fund të vitit 2005, këto duhet të ishin pasqyruar nga shoqëria në bilanc kontabël zyrtar të periudhës në zërin përkatës. Deklarimet dhe pretendimet e subjektit dhe pasqyrimet në raportin e audituesit nuk mbështeten në dokumentacionin kontabël të*

²¹ Sipas kontratës së huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2005, huaja është dhënë në ditën e nënshkrimit të saj.

²² Paragrafët 88, 88.1, 88.2, 89.1, faqja 11 e vendimit të Komisionit.

dorëzuar nga shoqëria në drejtorinë përkatëse tatimore. Trupi gjykues thekson se dhe në këtë rast vlerëson se ekzistenca e një lidhjeje midis shumës së përfituar në formë huaje në vitin 2005 dhe burimit të deklaruar nga subjekti rivlerësimi nuk u arrit të provohej. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me personat e tjerë të lidhur, shtetasit K.D. dhe F. A., rezulton jo vetëm të ketë ndryshuar burimin e krijimit të shumave të dhëna hua, nga person fizik në shoqëri tregtare, por gjendet i ndryshëm edhe nga deklarimi i subjektit mbi pagesën e vlerës pasi rezultoi se kjo pagesë ishte kryer nga shoqëria “{***}” ShPK, dhe i pambështetur në prova pasi nuk ka rezultuar nga hetimi asnjë dokument ligjor që të krijoj bindjen se dy shoqëritë kanë marrë përsipër ndonjë detyrim lidhur me apartamentin e subjektit.

48. Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për blerjen e apartamentit, ka marrë hua 2.000.000 lekë me kontrata noteriale, por nuk deklaruar emrat e huadhënësve.
49. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar, hua nga F. A., në shumën 1.000.000 lekë sipas kontratës së huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.9.2005 dhe hua nga K. D., në shumën 1.000.000 lekë, sipas kontratës së huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.8.2005.
50. Me kontratën e huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.8.2005, huadhënësi K. D. i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit një shumë prej 1.000.000 lekësh, e cila i jepet në datën 14.09.2005, me interes 3%, me një afat 2-vjeçar.
51. Nga aktet e fashikullit të Komisionit, rezulton se shoqëria “{***}” ShPK²³, ku z. K. D. është ortak dhe administrator, nuk ka shpërndarë dividend në vitin 2005, që mund të ketë shërbyer si burim për dhënien e huasë subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, referuar informacionit të përftuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë²⁴, K. D. rezulton i siguruar vetëm pjesërisht për periudhën 2002-2005, dhe paga mbi të cilën është derdhur kontributi, është në kufijtë e pagës minimale.
52. Në përgjigjet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se: Referuar të dhënave nga DRT-ja Vlorë, z. K. D. figuron i regjistruar si administrator i subjektit “{***}” ShPK, me NIPT {***}, në DRT-në Vlorë, në datën 18.07.2000. Subjekti ka deklaruar të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit për çdo vit. Nga pasqyrat financiare të vitit 2005, rezulton se ortaku i shoqërisë, njëkohësisht edhe administrator i saj, kryen të gjitha veprimet që shoqëria bën për blerje, shitje, arkëtime, pagesa, të drejtat dhe detyrimet ndaj tij dhe shoqërisë, të cilat kontabilizohen në llogarinë {***}, “llogaria e pronarit”, ose e thënë ndryshe gjendja e mjeteve të përdorura nga xhepi i pronarit. Kjo llogari në fund të periudhës, datë 31.12.2005, është gjendje në debi 1.906.576 lekë, që do të thotë se pronari i shoqërisë i detyrohet shoqërisë shumën prej 1.906.576 lekësh, për shkak se kjo llogari ka të bëjë me kontribute të pronarit në shoqëri ose pagesa me

²³ Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 21.08.2017, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë.

²⁴ Referuar informacionit nga DRSSH, Vlorë²⁴, të paraqitur nga subjekti me përgjigjet e rezultateve të hetimit, shtetasi K. D. ka paguar sigurime shoqërore dhe shëndetësore nga shoqëria “{***}” ShPK për periudhat: janar 2002 – qershor 2002, maj 2004 – dhjetor 2004 dhe janar 2005 – dhjetor 2005 (përfshijë muajt qershor 2005) dhe për të gjithë periudhën e sipërpërmendur ka qenë i siguruar për pagën minimale, me një vlerë totale prej 233.740 lekësh (bruto), ndërkohë që shpenzimet jetike për këtë periudhë (deri në shtator 2005), rezultojnë në një vlerë totale prej 354.630 lekësh.

mjete monetare cash, ajo konsiderohet si arka e pronarit. Huaja prej 1.000.000 lekësh që ortaku i shoqërisë, njëkohësisht dhe administrator i saj, i ka dhënë subjektit të rivlerësimit, është justifikuar nga mjete të disponueshme që shoqëria ka pasur gjatë vitit 2005, janë tërhequr nga ana e ortakut si detyrim dhe jo si ndarje dividendi. Shtetasi K. D. rezulton të ketë pasur të ardhura të depozituara në firmat piramidale përpara vitit 1997. Nga shkresa e administruar nga administratori i ish-firmave piramidale, rezulton se ky shtetas ka tërhequr një pjesë të depozitave/arkëtimeve të vendosura në këto shoqëri.

53. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, konstatoi se shuma 1.906.576 lekë në pasqyrat financiare të shoqërisë “{***}” ShPK, pasqyron gjendjen e likuiditeteve, para në arkën e shoqërisë “{***}” ShPK në datën 31.12.2005 dhe jo detyrime të ortakut ndaj shoqërisë. Veprimet financiare të administratorit të shoqërisë K. D. në llogarinë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK, nuk provojnë se ky i fundit ka tërhequr shumën 1.000.000 lekë në datën e dhënies së huasë²⁵ në formën e një detyrimi ndaj shoqërisë dhe, po ashtu, nuk rezulton që shoqëria “{***}” ShPK, si person juridik, t’i ketë dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën e transferuar drejt shoqërisë “{***}” ShPK më datë 27.09.2005, për blerjen e apartamentit, dhe as nuk rezultoi që kjo shoqëri për vitin 2005, të ketë kontabilizuar detyrime të ortakut, administratorit apo huadhënie për të tretët. Ndërsa ligji i kohës, nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”, parashikonte ndalim për administratorin e shoqërisë për dhënien e huave ndaj të tretëve nga shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pretendimi i subjektit se shuma 1.906.576 lekë kanë qenë mjete të disponueshme që shoqëria ka pasur gjatë vitit 2005 dhe janë tërhequr nga ana e ortakut si detyrim, vlerësohet i pambështetur në fakte e në prova.
54. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se huaja e dhënë vërtetohet sipas transfertës bankare, trupi gjykues, nga verifikimi i llogarisë bankare me nr. {***}, të shoqërisë “{***}” ShPK në BKT, konstatoi se në datën 27.09.2005, nga kjo llogari është kryer një transfertë me përfitues shoqërinë “{***}” ShPK, me shumë 3.000.000 lekë dhe me përshkrimin: “*Dritan Marku sa kalon për {***} detyrim për blerje shtëpie*”. Sipas deklarimeve të subjektit, shuma 3.000.000 lekë, transferuar nga shoqëria “{***}” ShPK më datë 27.09.2005, përbëhet nga: (i) shuma 700.000 lekë me burim krijimi kursimet e subjektit; (ii) 300.000 lekë dhuratë nga vjehri P. LL. (iii) 1.000.000 lekë hua nga shtetasi F. A. dhe 1.000.000 lekë hua nga shtetasi K. D. Ndërkohë që, nga verifikimi i llogarisë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK, rezulton se shuma 3.000.000 lekë është krijuar nga: (i) shuma 800.000 lekë transferuar nga shoqëria “{***}” ShPK në datën 27.09.2005, me përshkrimin: “*{***} sa kalon për f. SH., detyrim lik. fat.*”; (ii) 526.275 lekë transferuar nga P. LL. në datën 27.09.2005, me përshkrimin: “*P. LL. sa kalon për F. SH., detyrim*”; dhe (iii) shuma 1.673.725 lekë nga fondet në llogarinë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK. Në këtë llogari bankare, nuk evidentohen gjurmë mbi transferimin e shumës 700.000 lekë nga kursimet e subjektit, deklaruar si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie dhe nuk rezulton që të jetë transferuar as shuma prej 1.000.000 lekësh që subjekti i

²⁵ Në muajin shtator 2005, është bërë vetëm një depozitim cash prej 500.000 lekësh nga K. D. (huadhënësi) në llogarinë nga e cila është kryer transfertat.

rivlerësimit deklararon se kishte marrë hua nga huadhënësi K, D. sipas kontratës së huasë në datën 14.09.2005. Në këto kushte, pavarësisht se pagesa e kështit është kryer nëpërmjet transfertës bankare, ky fakt është i pamjaftueshëm për të konkluduar lidhur me burimin dhe ligjshmërinë e fondeve që kanë shërbyer për shlyerjen e kështit të parë në vlerën 3.000.000 lekë, më datë 27.09.2005. Bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për moskonsiderimin e kësaj huaje si burim financiar i ligjshëm për blerjen e pasurisë objekt kontrolli dhe pasi subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur, z. K. D., nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar burimin e ligjshëm të huasë në shumën 1.000.000 lekë.

55. Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie duhet të përfshihet e gjithë shuma gjendje *cash* e deklaruar pas ndryshimeve në DIPP-në e vitit 2004, trupi gjykues, nga verifikimi i deklarimit të ndryshuar të subjektit në DIPP-në e vitit 2004, konstatoi se, në rubrikën “Pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme” të kësaj deklarate, sipas korrigjimit të bërë në datën 10.11.2006, subjekti ka deklaruar: *Gjendje cash në shtëpi 500.000 lekë + 100.000 lekë, shtesa vjetore 100.000 lekë*. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 28.1.2016, në lidhje me mosdeklarimin e gjendjeve *cash* në vitet 2003 – 2004, subjekti ka shpjeguar se: *Këto pasaktësi kanë ardhur si pasojë e mosdijenisë dhe mospasjes së informacionit të duhur për plotësimin e saktë të deklaratave të interesave privatë [...]*. Për sa më sipër, nisur nga fakti që në DIPP-2004, subjekti ka bërë një deklarim jo të qartë të gjendjes *cash* në banesë, nga mënyra e deklarimit në këtë deklaratë, duket se gjendja *cash* në banesë në atë vit ka qenë 500.000 lekë, nga të cilat 100.000 lekë janë shtesë në vitin 2004. Referuar vendimit të Komisionit, rezulton se në analizën financiare është mbajtur parasysh deklarimi që subjekti ka bërë në DIPP-në e vitit 2005 për përdorimin e gjendjes *cash* se: *Përdorimi i cash-it në shtëpi për blerje apartament banimi (-) 400.000 lekë*. Gjithsesi, Komisioni ka arsyetuar se: *edhe nëse do të përfshihej e gjithë shuma e gjendjeve cash, deklaruar në DPV-në e vitit 2004 (vlera 500.000 lekë pas ndryshimeve) përsëri balanca e fondeve do të mbetet negative në vlerën (-) 2.256.794 lekë*. Megjithëse subjekti i rivlerësimit ngre pretendim për përfshirjen në analizën financiare të të gjithë shumës gjendje *cash* pas ndryshimeve të DPV-së së vitit 2004, nuk rezulton të ketë treguar një vlerë konkrete për të cilën pretendon se nuk i është përlllogaritur nga Komisioni, ndërkohë që në aktin e ekspertimit të përgatitur nga eksperti kontabël A. M., i cili ka përpiluar një analizë financiare me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, rezulton se gjendja *cash* është përlllogaritur në vlerën 500.000 lekë (faqe 5 e këtij akti). Sa më sipër, trupi gjykues nuk e gjen të gabuar përlllogaritjen nga Komisioni të pakësimit të gjendjes *cash* sipas deklarimit që vetë subjekti ka bërë për përdorimin e gjendjes *cash* për blerjen e apartamentit në DIPP-në e vitit 2005, në shumën 400.000 lekë, por sikurse Komisioni, për një qëndrim garantist ndaj subjektit të rivlerësimit, vlerëson se edhe nëse do të përlllogaritet pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 500.000 lekë, balanca e fondeve ngelet negative, sikurse është arsyetuar në këtë vendim.
56. Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën financiare nuk janë përlllogaritur të ardhurat *neto* të pagës për 9 muaj, për vitin 2005, trupi gjykues konstatoi se në rezultatet e hetimit, Komisioni, në analizën financiare për periudhën 1.1.2005 – 27.9.2005, ka përlllogaritur të

ardhura nga marrëdhënia e punësimit të subjektit të rivlerësimit sipas të dhënave për të ardhurat mujore nga paga në llogarinë e tij bankare në Raiffeisen Bank, në vlerën 420.726 lekë, ndërsa vlera totale vjetore për vitin 2005 është përlllogaritur në vlerën 978.848 lekë, sipas të dhënave në shkresën nr. {***} prot., datë 19.01.2017, të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, e cila pasqyron sasinë e të ardhurave *neto* nga pagat, shtesat dhe shpërblimet për të gjithë vitin 2005, por nuk jep të dhëna dhe detaje në lidhje me pagën *neto* mujore të përfituar dhe as nuk përcakton shtesat dhe shpërblimet, si dhe kohën e përfitimit të tyre përgjatë vitit 2005. Nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit, me nr. {***}, në Bankën Raiffeisen, rezulton se për vitin 2005, kalimi i pagës së subjektit ka filluar në datën 01.04.2005 dhe përpara kësaj periudhe, nuk ka të dhëna në lidhje me pagën e subjektit në asnjë nga llogaritë bankare të tij. Sa më sipër, trupi gjykues e gjeti të drejtë pretendimin e subjektit se në analizën financiare të periudhës 1.1.2005 – 27.9.2005, duhen përlllogaritur të ardhurat nga paga *neto* e subjektit sipas vërtetimit të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në shumën 734.136 lekë.

57. Në lidhje me pretendimin e subjektit për mospërfshirjen në analizë financiare të shpenzimeve për qiranë, në shumën 72.000 lekë për vitin 2005, pasi për periudhën shtator 2004 deri në vitin 2007, ka qëndruar në banesën e vjehrrit në lagjen “{***}”, nr. {***}, Vlorë, trupi gjykues konstatoi se, në rezultatet e hetimit, në analizën financiare për periudhën 01.01.2005 deri 31.12.2005, referuar deklaramëve të subjektit në deklarinimin për herë të parë, si dhe në procesverbalin e datës 28.1.2016 pranë ILDKPKI-së, se në vitet 2003 – 2007 ka jetuar në disa banesa të ndryshme në Vlorë me qira dhe shpenzimet kanë qenë në vlera rreth 5.000 - 8.000 lekë/muaj, Komisioni ka përlllogaritur shpenzime qiraje në shumën 72.000 lekë. Referuar DIPP-2003, rezulton se subjekti i rivlerësimit, si adresë banimi, ka deklaruar lagjen “{***}”, nr. {***}, Vlorë, dhe po ashtu ka deklaruar banesë me qira 1+1 me detyrim mujor 6.000 në muaj. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Në fillim të vitit 2003, kam marrë një shtëpi me qira në lagjen “{***}”, nga shtetasi B. T., me pagesë mujore 6.000 (gjashtë mijë) lekë në muaj. Kam qëndruar deri në shtator të vitit 2004. Nga shtatori i vitit 2004 e deri në vitin 2007 kam qëndruar te banesa e vjehrrit tim P. LL. në lagjen “{***}”.* Në deklarinimet periodike vjetore 2004, 2005 dhe 2007, adresa e banimit rezulton të jetë deklaruar lagjja “{***}”, nr. {***}, Vlorë, ndërkohë për vitin 2006 dhe 2008, subjekti ka deklaruar adresën: lagjja “{***}”, Vlorë, pa numër banese. Në mbështetje të deklaramëve të tij, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.12.2019, të z. B. T., i cili deklaron se subjekti i rivlerësimit ka banuar me qira në banesën e këtij të fundit në lagjen “{***}” nga viti 2003 deri 2004. Po ashtu, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2019, z. P. LL., babai i bashkëshortes së subjektit, ka deklaruar se dhëndri i tij ka banuar në banesën e tij pa qira, nga muaji shtator 2004 deri në vitin 2007. Të dyja banesat rezultojnë në lagjen “{***}”, Vlorë. Sa më sipër, bazuar në faktin se sipas certifikatës së martesës nga Zyra e Gjendjes Civile {***}, Lezhë, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë lidhur martesë më datë 18.08.2003 dhe ka deklaruar banim me qira vetëm në DIPP-në e vitit 2003, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se nga muaji shtator 2004 ka filluar të banojë pa pagesë në banesën e vjehrrit të tij, duket i besueshëm dhe, për

rrjedhojë, vlerësoi se shpenzimet e qirasë për vitin 2005 nuk duhet të përfshihen në analizën financiare për periudhën 01.01.2005 deri 31.12.2005.

58. Lidhur me pretendimin e subjektit se *shpenzimet e udhëtimit duhet të jenë 98.064 lekë nga 110.322 lekë, sepse janë 6 ditë udhëtimi dhe jo 7 ditë, ka qëndruar në traget gjithë natën në kthim (në udhëtimet me traget për shkak të kohës së gjatë të udhëtimit, dita e ikjes dhe e ardhjes nuk duhet të konsiderohen si dy ditë qëndrimi)*, trupi gjykues, nga verifikimi i të dhënave të sistemit TIMS, konstatoi se subjekti dhe bashkëshortja në vitin 2005, kanë pasur vetëm një udhëtim jashtë shtetit, në datat 27.08.2005 – 03.09.2005, në {***}, Itali. Për këtë periudhë, Komisioni i ka llogaritur 7 ditë udhëtimi, ndërkohë, sipas të dhënave rezultojnë 7 net dhe 8 ditë qëndrimi, megjithatë dita e tetë e kthimit nuk është llogaritur nga Komisioni. Sa më sipër, rezulton se Komisioni e ka kryer saktë përlllogaritjen e ditëve të qëndrimit dhe të shpenzimeve përkatëse, në përputhje me metodologjinë e Kolegjit dhe, si rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.
59. Në përfundim, referuar analizës së saktësisë së deklarimeve që subjekti i rivlerësimit ka bërë lidhur me pasurinë objekt kontrolli, si dhe të secilit burim financiar të deklaruar për krijimin e saj, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 2.300.000 lekë²⁶, lidhur me pasurinë “apartament banimi”, me sipërfaqe 103,07 m², të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
- *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë:*
60. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë, ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit²⁷ se: *Nga faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, nënshkrimi i kontratës së shitblerjes dhe regjistrimi i saj u kryen kur blerësi A. D. nuk ishte prezent në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke passjellë konkluzionin që vërtetësia e thënieve nuk është në pajtueshmëri me provat dhe besueshmërinë e tyre, në zbatim të përcaktimit të pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion mbështetet dhe në faktin se edhe në ditën e nënshkrimit të deklaratës noteriale të datës 26.1.2017, shtetasi A. D. nuk ishte prezent në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke konfirmuar përpjekjen e vazhdueshme të subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave që lidheshin me justifikimin e burimeve prej saj. Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti t’i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke u gjendur në parashikimet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 lidhur me këtë pasuri. Për të gjitha sa u arsyetua më lart, bazuar në analizën e orientuar prej pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në konkluzionin se të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga kjo marrëdhënie e kaparit, nuk duhet të merren në konsideratë në analizë financiare, si burim*

²⁶ Për shkak të dështimit të subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin financiar të ligjshëm të dhurimit nga vjeherri P. LL. të shumës 300.000 lekë, si dhe të huave nga shtetasi F. A. dhe K. D.

²⁷ Paragrafët 128 deri 132, në faqen 16 të vendimit të Komisionit.

krijimi për pasuritë vijuese të subjektit të rivlerësimit, pasi nuk u provua nga subjekti ligjshmëria në formë dhe përmbajtje e mënyrës së përfitimit të tyre dhe se shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk ishin në pajtueshmëri me provat dhe legjislacionin në fuqi. Mbështetur në argumentet e mësipërme, trupi gjykues arriti gjithashtu në konkluzionin se qasja dhe sjellja e subjektit, si: nënshkrimi i dokumenteve para noterit publik, pa pasur prezent palën tjetër, në qytetin ku kryente funksionin e prokurorit dhe njihej si i tillë, përbëjnë zgjedhje të cilat jo vetëm nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por edhe e dëmtojnë atë.

61. Subjekti e ka bazuar shkakun e ankimit në pretendimet se, me provat e administruara gjatë hetimit administrativ dhe me provat e depozituara prej tij bashkëlidhur prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se të ardhurat e përfituara nga kontrata e vitit 2013 janë tërësisht të ligjshme, të deklaruara me vërtetësi në deklaratimet periodike vjetore dhe se nuk janë kryer veprime fiktive nga ana e tij pasi sjellja e palëve ka qenë në përputhje të plotë me vullnetin e përcaktuar në kontratën e shitjes me kusht. Si rrjedhojë, ankuesi nuk ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë sepse nuk ka kryer asnjë veprim në kundërshtim me ligjin apo rregullat e etikës. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se:

61.1. Për shitjen e apartamentit, është lidhur fillimisht kontrata (e titulluar “Kontrata e kaparit”) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.11.2013, me palë shitëse ankuesin dhe palë blerëse shtetasin A. D. Në marrëveshje ndërmjet tij dhe blerësit A. D., është rënë dakord për çmimin e shitjes në shumën 45.000 euro, nga të cilat 20.000 euro pala blerëse e ardhshme i ka likuiduar më datë 4.11.2013, ndërsa për pjesën tjetër prej 25.000 eurosh, palët kanë rënë dakord që shuma 10.000 euro të likuidohet në muajin gusht të vitit 2014 dhe pjesa e mbetur në shumën 15.000 euro të likuidohet deri në dhjetor të vitit 2015. Pavarësisht parashikimeve të kontratës, çmimi i shitjes së apartamentit është likuiduar tërësisht në fund të vitit 2014. Në vitin 2013, blerësi A. D., përveç shumës 20.000 euro, likuidoi edhe shumën 10.000 euro, gjithsej shumën 30.000 euro, ndërsa pjesa tjetër në shumën 15.000 euro u pagua prej tij gjatë vitit 2014. Këto shuma janë deklaruar rregullisht dhe me saktësi në DPV-të vjetore.

61.2. Në kontratë është përcaktuar se në gusht të vitit 2014, do të dorëzohen nga pala shitëse e ardhshme çelësat e apartamentit dhe ai do të kalojë në përdorim të palës blerëse të ardhshme. Në nenin 4 të kontratës është parashikuar që blerësi i ardhshëm do të bëhet pronar i apartamentit, pasi të lidhet kontrata e shitjes pranë zyrës noteriale.

61.3. Komisioni, pavarësisht se i ka kaluar ankuesit barrën e provës, duke e akuzuar se ka bërë deklaratime të pavërteta, nuk e ka lejuar të paraqesë prova që provojnë burimin e ligjshëm të A. D. për pagesat e bëra, fakt i cili tregon për një vendimmarrje të paracaktuar dhe një proces jo të rregullt ligjor.

61.4. Kontrata e lidhur me z. A. D. nuk është kontratë kapari, por një kontratë shitjeje me kusht dhe qëllimi i vërtetë dhe i vetëm i palëve në këtë kontratë, ka qenë shitblerja e këtij apartamenti. Argumenti i përdorur nga Komisioni, se parashikimet e nenit 4 të kontratës, tregojnë se qëllimi i palëve nuk ka qenë lidhja e kontratës, është jologjik dhe artificë për të mbështetur vendimin e paracaktuar të tij.

61.5. Apartamenti, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, i është dorëzuar z. D. në muajin gusht 2014, siç përshkruhet në kontratën e vitit 2013, fakt që vërtetohet nga faturimi i ulur i energjisë në këtë apartament për periudhën gusht 2014 e në vijim. Kjo provë, e analizuar së bashku me hyrje-daljet në kufi të blerësit A. D., tregon se apartamenti i është dorëzuar atij në përputhje me parashikimet në kontratë dhe se ky apartament është përdorur prej tij në kohën kur ai ka qëndruar në Shqipëri. Ky apartament nuk është përdorur prej subjektit që prej muajit gusht të vitit 2014.

61.6. Pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, apartamenti është regjistruar në pronësi të blerësit dhe nuk është i drejtë konstatimi i Komisionit se subjekti ka hequr dorë vetëm formalisht nga pronësia. Edhe pse juridikisht kontrata e shitblerjes është lidhur në vitin 2017, blerësi A. D. e ka poseduar dhe gëzuar qetësisht apartamentin që prej muajit gusht 2014, ndërsa ai ka përfituar çmimin e apartamentit siç është parashikuar realisht në kontratë.

61.7. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.08.2014, noteri i është referuar kështu i dytë, si dokument i dytë noterial i nënshtruar për pagesën e shumës, por që nuk tregon faktin se pagesa e kështit të dytë është kryer në këtë datë. Konstatimi i Komisionit se ka mospërputhje ndërmjet kësteve të parashikuara në kontratën e kaparit dhe atyre të paguara faktikisht, nuk është ndonjë e dhënë e cila përbën shkelje ligjore apo etike, por një sjellje normale mes palëve. Në kushtet kur blerësi mori përsipër shlyerjen e detyrimit në një kohë sa më të përshtatshme për të, duke e kryer likuidimin më përpara, kjo nuk sjell asnjë pasojë apo shkelje të ndonjë dispozite ligjore.

61.8. Pas arkëtimit të të gjithë shumës sipas kontratës, i ka kërkuar vazhdimisht blerësit të nënshkruanin kontratën e shitjes, gjë e cila nuk ka ndodhur për arsye objektive që lidhen me kohën e shkurtër kur blerësi vinte në Shqipëri dhe problematikat që ai kishte. Blerësi ka pasur mundësi financiare për blerjen e këtij apartamenti, siç rezultoi edhe nga dokumentacioni justifikues – vetëm në vitin 2013, ai ka pasur të fitim neto nga aktiviteti në shumën 14.162 euro.

61.9. Ankuesi ka këmbëngulur të lidhë kontratën e shitjes përpara përpilimit të deklaratës *vetting* jo me qëllim që të hiqte dorë formalisht nga pronësia, siç padrejtësisht arrin në konkluzion shumica e Komisionit, por me qëllimin që subjekti të pasqyroste saktë në deklaratën *vetting* faktet e ndodhura.

61.10. Pavarësisht vonesës në lidhjen e kontratës së shitjes për shkak të blerësit, ky apartament është shitur dhe ankuesi ka përfituar pagesat sipas deklarimeve të bëra në deklaratimet periodike vjetore dhe provave që gjenden bashkëlidhur prapësimeve, ku vërtetohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm dorëzimi faktik i këtij apartamenti në muajin gusht 2014. Kontrata finale e shitjes është nënshkruar realisht dhe palët kanë shprehur vullnetin e tyre të pavesuar në kontratë. Në praktikën e veprimeve noteriale, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në botë, njihet nënshkrimi i kontratave në data të ndryshme nga palët. Nënshkrimi i kontratës është bërë prej tij, pasi është plotësuar praktika sipas kërkesave të noteres dhe nuk ka asnjë të dhënë fiktive dhe çdo fakt në të është pasqyruar me vërtetësi.

62. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit dhe i analizoi ato në raport me vendimin e Komisionit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

62.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se: *Në vitin 2013, e kam shitur këtë banesë me kontratë noteriale. Nuk është bërë kalimi i pronësisë në emër të blerësit A. D., për shkaqe të pavarura nga ana ime, pasi është emigrant dhe jeton jashtë. Ajo aktualisht figuron në emrin tim, megjithëse më ka likuiduar plotësisht. 20.000 euro nga shitja e kësaj banese i kam depozituar në nëntor 2013 në Bankën Intesa.*

62.2. Në DIPP-2013, subjekti ka deklaruar se: *Kam shitur apartamentin në Vlorë me sip.103,07 m² në shumën 45.000 euro. Për këtë, kam bërë një kontratë kapari në datën 4.11.2013. Sipas kësaj kontrate, blerësi i banesës sime duhet të më likujdojë deri në vitin 2015. Në fakt, në vitin 2013, blerësi më ka dhënë 30.000 euro, nga të cilat 20.000 euro në momentin e lidhjes së kontratës në datën 4.11.2013 i ka depozituar në bankë²⁸ dhe pjesën tjetër e kam përdorur për të shlyer detyrimet (10.000 euro më janë dhënë pjesë –pjesë deri në fund të vitit 2013).*

62.3. Referuar përmbajtjes së kontratës së kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 4.11.2013, rezulton se palët kanë rënë dakord për pagimin e shumës 45.000 euro, nga të cilat 20.000 euro pala blerëse e ardhshme ia ka likuiduar palës shitëse të ardhshme në datën 4.11.2013, ndërsa për pjesën tjetër, prej 25.000 eurosh, është rënë dakord se, në muajin gusht të vitit 2014, do të likujdohej shuma prej 10.000 eurosh, ndërsa deri në dhjetor të vitit 2015, do të likujdohej shuma e mbetur prej 15.000 eurosh. Gjithashtu, në këtë kontratë është përcaktuar se në muajin gusht të vitit 2014, apartamenti do të dorëzohej nga pala shitëse e ardhshme, në përdorim të palës blerëse të ardhshme. Kjo kontratë, në nenin 4 të saj, parashikonte që blerësi i ardhshëm do të bëhej pronar i pasurisë objekt kontrate, vetëm pas lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës së shitjes pranë zyrës noteriale.

62.4. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.8.2014, me palë deklaruese subjektin e rivlerësimit dhe shtetasin A. D., palët deklarojnë pagesën dhe marrjen e kështit të dytë në shumën 10.000 euro.

62.5. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 26.1.2017, me palë deklaruese subjektin e rivlerësimit dhe shtetasin A. D., shtetasi A. D. deklaroi se gjatë viteve 2013-2014 ka shlyer *cash* gjithë detyrimet për blerjen e apartamentit me sip. 103,07 m², në favor të z. Dritan Marku. Në të njëjtën deklaratë, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka marrë të gjithë shumën prej 45.000 eurosh nga z. A. D., ndaj të cilit nuk ka asnjë pretendim.

62.6. Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., {***} kol., datë 28.1.2017, me palë shitëse subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij dhe palë blerëse shtetasin A. D., është kryer shitja e pasurisë apartament me sip. 103,07 m². Në nenin 3 të kësaj kontrate, është përcaktuar se: *Palët ranë dakord dhe me marrëveshje vendosën çmimin e*

²⁸ Referuar të dhënave nga Intesa Sanpaolo Bank, rezulton se në llogarinë nr. {***}, Dritan L. Marku, më 5.11.2013, është kryer veprimi bankar, *cash* Dritan Marku, me përshkrimin: “Të ardhura nga kontratë e shtëpisë, pasuri e paluajtshme nga shitje apartamenti”, shuma 20.000 euro. Depozituar me afat deri në datën 5.5.2015.

shitjes së kësaj pasurie në shumën 45.000 euro. Vlera e plotë e çmimit është likuiduar totalisht sipas kontratës së kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 4.11.2013, dhe deklaratave noteriale.

62.7. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni²⁹ i ka kërkuar subjektit të shpjegojë arsyet se përse kontrata e shitblerjes së pasurisë është realizuar vetëm pas dorëzimit të deklaratës vetting, në datën 28.1.2017, datë në të cilën, referuar sistemit TIMS, shtetasi A. D. nuk ka qenë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Po ashtu, i ka kërkuar të japë shpjegime se, megjithëse çmimi i blerjes së kësaj pasurie pretendohet i paguar plotësisht nga shtetasi A. D. dhe ky i fundit, sipas sistemit TIMS, ka rezultuar se ka hyrë disa herë në Shqipëri në vitet 2014, 2015 dhe 2016, kjo kontratë nuk është nënshkruar më parë.

62.8. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka shpjeguar se: *Ky fakt është i vërtetë, por është kryer në këto rrethana: Blerësi ka qenë vazhdimisht, përfshirë edhe këtë periudhë, jashtë shtetit si emigrant. Çmimin e shitjes, blerësi e ka paguar me këste dhe ka shlyer përfundimisht shumën në fund të vitit 2014. Pasi ka paguar detyrimin e fundit, ne nuk kemi mundur të takohemi dhe, në kushtet e mirëbesimit reciprok, e kemi lënë që kontrata të bëhej në një moment të mëvonshëm.*

62.9. Në lidhje me faktin se blerësi në çastin e nënshkrimit të kontratës nuk ka qenë në Shqipëri, subjekti ka shpjeguar se: *Kontrata e shitjes mban datën 28.1.2017, pasi palët në kontratë, pra, shitësi dhe blerësi, kishin rënë dakord për shitjen e sendit objekt kontrate, por për kryerjen e aktit formal të tjetërsimit të pasurisë përpara noterit, ishte e nevojshme edhe kartela e pasurisë e freskët, e nevojshme kjo për të vërtetuar faktin se kjo pasuri nuk kishte ndonjë barrë apo pengesë tjetër ligjore [...]. Pala blerëse erdhi në Shqipëri, por për nevoja të punës duhej të largohej përsëri jashtë shtetit dhe nuk mund të priste deri në marrjen e konfirmimit të zyra e hipotekës, apo Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, se kjo pronë nuk ka asnjë barrë apo pengesë tjetër ligjore. Për këtë shkak, kemi shkuar përpara noterit publik dhe kemi nënshkruar kontratën me klauzolën që do të lëshohej përfundimisht nga noteri pasi ai të kishte në dispozicion edhe kartelën e pasurisë së paluajtshme që kjo pasuri nuk kishte ndonjë ndalim ligjor, për t'u shitur apo për t'u blerë. Nëse vërehet kjo kartelë, rezulton se ajo është lëshuar nga ZVRRP, Vlorë, në datën 25.01.2017. Më tej, nëse vërehet kontrata e shitjes, data e saj është shkruar me shkrim dore dhe jo të ruajë vijimësinë e përmbajtjes tërësore të saj.*

63. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues konstaton se, megjithëse ankuesi pretendon se kishte marrë nga blerësi A. D. të gjithë çmimin e parashikuar në kontratën e kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 4.11.2013, që në fund të vitit 2014 dhe ia kishte dorëzuar apartamentin blerësit që në muajin gusht të vitit 2014, kontrata e shitjes është lidhur pas dorëzimit nga subjekti i rivlerësimit të deklaratës vetting.

64. Lidhur me vonesën për lidhjen e kontratës së shitjes, trupi gjykues i gjen të panatyrshme pretendimet e ankuesit se, megjithëse blerësi A. D. pas vitit 2014 kishte ardhur disa herë në Shqipëri, e kishte pasur të pamundur të nënshkruante kontratën e shitjes, pavarësisht se kishte

²⁹ Në pyetësin nr. 2.

paguar çmimin e blerjes prej 45.000 eurosh dhe, si rrjedhojë, e gjen të drejtë konstatimin e Komisionit³⁰ se: *Sa më sipër, z. A. D., në një disfavor të qartë dhe në mospërputhje me çdo logjikë ekonomike, pasi kishte paguar 45.000 euro dhe kishte tetë hyrje-dalje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga disaditore në dyjavore, nuk u investua për të përfitur përfitim të pasurisë.*

65. Lidhur me pretendimin e ankuesit se arsyeja e formalizimit të kontratës së shitjes në datën 28.01.2017, ndërkohë që blerësi A. D. në këtë datë ka qenë jashtë territorit të Shqipërisë, shpjeguar me faktin se noterja në momentin që ankuesi dhe blerësi u paraqitën në zyrën noteriale dhe e nënshkruan personalisht kontratën, nuk kishte mundur të plotësonte dokumentacionin e nevojshëm të pronësisë së apartamentit dhe, si pasojë, kontrata u formalizua pas plotësimit të dokumentacionit nga noterja, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se, në ankim, subjekti i rivlerësimit nuk jep asnjë shpjegim lidhur me nënshkrimin prej tij dhe blerësit A. D. të deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 26.1.2017, me palë deklaruese, subjektin e rivlerësimit dhe shtetasin A. D., në një datë kur blerësi A. D. rezultojnë të ketë qenë përsëri jashtë territorit të Shqipërisë. Në rast se vërtet subjekti i rivlerësimit dhe blerësi A. D. janë paraqitur para noteres për lidhjen e kontratës në një datë kur blerësi ndodhej në Shqipëri, ankuesi do të duhej të shpjegonte përpara Komisionit dhe Kolegjtit se përse deklarata noteriale e sipërcituar nuk u bë në atë datë, pasi nuk rezultojnë të ketë pasur asnjë pengesë për noteren dhe palët deklaruese që ky akt noterial të hartohej dhe nënshkruhej në atë moment. Fakti që subjekti i rivlerësimit nuk jep asnjë shpjegim se përse e ka nënshkruar këtë deklaratë noteriale në kushtet e mungesës së deklaruesit A. D., ndërkohë që ai ka qenë në dijeni të plotë të faktit se blerësi A. D. kishte ardhur në Shqipëri në datën 31.12.2016 dhe ishte larguar më datë 07.01.2017, pasi e ka pohuar këtë dijeni në përgjigjet e dhëna ndaj rezultateve të hetimit³¹, justifikon si të drejtë konkluzionin e arritur nga Komisioni³² se ky fakt ka konfirmuar përpjekjen e vazhdueshme të subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave, që lidheshin me justifikimin e burimeve prej saj. Bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues e vlerëson të pabesueshëm pretendimin e subjektit se nënshkrimi i kontratës së shitjes nga palët është bërë nga blerësi A. D. gjatë ditëve të qëndrimit të tij në Shqipëri.

66. Trupi gjykues vlerëson se fakti që deklarata noteriale e datës 26.01.2017, është hartuar në mungesë të deklaruesit A. D., e bën të pabesueshëm edhe pretendimin e subjektit se pagesa e çmimit është bërë gjatë viteve 2013-2014. Gjithashtu, ky pretendim është në kundërshtim edhe me përmbajtjen e deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.8.2014, me palë deklaruese subjektin e rivlerësimit dhe shtetasin A. D., në të cilën ky i fundit ka deklaruar se: *Sot, më datë 13 gusht 2014, unë, A. D., deklaroj se kam shlyer këstin e dytë prej 10.000 eurosh, kurse subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: Unë i nënshkruari Dritan Marku, deklaroj se kam marrë vlerën prej 10.000 eurosh nga z. A. D.* Përmbajtja e kësaj deklarate noteriale e bën të

³⁰ Paragrafi 126, në faqen 15 të vendimit të Komisionit.

³¹ Paragrafët nr. 48 dhe nr. 79 të aktit "Observacion i prokurorit Dritan Marku mbi rezultatet e hetimit", protokolluar në Komision në datën 25.06.2021.

³² Paragrafi 129, në faqen 16 të vendimit të Komisionit

pabesueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se gjatë vitit 2013, ai kishte marrë nga blerësi edhe shumë prej 10.000 eurosh.

67. Lidhur me pretendimin e ankuesit se apartamenti i është dorëzuar blerësit në gusht të vitit 2014, trupi gjykues konstaton se ky pretendim vjen në kundërshtim me shpjegimet që ai ka bërë në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit të datës 06.12.2019, të dërguara nga subjekti me e-mail-in e datës 20.12.2019, ku ka deklaruar se: [...] *Nga shtatori i vitit 2004 e deri në vitin 2007, kam qëndruar te banesa e vjehrrit tim P. LL., në lagjen “{***}”. Nga ajo periudhë e deri në fund të vitit 2015, kam jetuar në banesën time, Njësia Administrative nr. {***}, lagjja “{***}”-203, Bashkia Vlorë. [...] Në vitin 2007, kur kam shkuar për të jetuar në banesën që kam blerë në vitin 2005, me adresë: Njësia Administrative nr. {***}, lagjja “{***}”-{***}, Bashkia Vlorë, i kam marrë të gjitha mobiliet dhe pajisjet elektrike që ndërkohë i kisha blerë para, gjatë dhe pas martesë, dhe i kam vendosur atje. Trupi gjykues konstaton gjithashtu se palët, në deklaratën noteriale të muajit gusht 2014, kanë pranuar likuidimin e kështit të dytë, por nuk kanë deklaruar dorëzimin e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit te pala blerëse, sipas pikës 3.2 të kontratës së kaparit. Si rrjedhojë e analizës së mësipërme, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit u konsiderua i paprovuar, pavarësisht nga dokumentacioni i paraqitur prej tij për faturimin e energjisë elektrike për periudhën nga muaji gusht 2014 e në vijim.*

68. Në përfundim të analizës së mësipërme të situatës faktike të konstatuar nga provat e administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit se: *të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga kjo marrëdhënie e kaparit, nuk duhet të merren në konsideratë në analizë financiare, si burim krijimi për pasuritë vijuese të subjektit të rivlerësimit, pasi nuk u provua nga subjekti ligjshmëria në formë dhe përmbajtje e mënyrës së përfitimit të tyre dhe se shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk ishin në pajtueshmëri me provat dhe legjislacionin në fuqi.*

69. Lidhur me vlerësimin e Komisionit se *nënshkrimi i dokumenteve para noterit publik, pa pasur prezent palën tjetër, në qytetin ku kryente funksionin e prokurorit dhe njëhej si i tillë, përbëjnë zgjedhje të cilat jo vetëm nuk shërbejnë për krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por edhe e dëmtojnë atë*, trupi gjykues vlerëson se kjo situatë faktike, në kushtet kur është vlerësuar në kuadër të kriterit të kontrollit të pasurisë sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nuk duhet të kualifikohet edhe sipas nenit 61, pika 5 e këtij ligji, por u mbajt në konsideratë në kuadër të vlerësimit të besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit për vlerësimin e kriterit të pasurisë në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Lidhur me automjetin “Mercedes Benz”:*

70. Ankuesi, lidhur me automjetin “Mercedes Benz”, ka kundërshtuar si të gabuar vlerësimin e Komisionit se: *(i) të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga shitja e automjetit, nuk duhet të merren në konsideratë në analizë financiare, si burim krijimi për pasuritë vijuese të subjektit të rivlerësimit, pasi nuk u provua nga subjekti, ligjshmëria në formë dhe përmbajtje e mënyrës së përfitimit të tyre dhe se shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk ishin në pajtueshmëri me provat dhe legjislacionin në fuqi; (ii) subjekti i rivlerësimit, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi çmimi i referuar*

në kontratën e shitjes, si dhe shpjegimet nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerën reale të shitjes.

71. Subjekti i rivlerësimit, shkakun e ankimit e ka bazuar në pretendimet se automjeti është blerë sipas kontratës së datës 24.08.2009, në vlerën e përcaktuar në kontratë dhe nuk ka konflikt interesi me shitësin. Në momentin e blerjes, automjeti ka pasur motorin në gjendje jo të mirë dhe, për këtë arsye, ka kryer një sërë shërbimesh të cilat kanë rritur vlerën e tij. Dokumentacioni që vërteton shpenzimet për mirëmbajtjen e automjetit, nuk është ruajtur për shkak se, nga koha e kryerjes së këtyre shërbimeve, kanë kaluar më shumë se 10 vjet, dhe se në vitin 2009, deklarimi i shpenzimeve në deklaratat periodike vjetore nuk ka qenë detyrim ligjor. Vlera e automjetit është rritur për shkak të shërbimeve teknike që janë kryer në të dhe çmimi i shitjes është ai i përcaktuar në kontratë. Sipas subjektit, fakte të tilla në jurisprudencën e Komisionit nuk janë konsideruar asnjëherë si shkaqe të cenimit të besimit të publikut dhe dyshimet mbi vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes jo vetëm që janë në kundërshtim me faktet e pasqyruara në një akt zyrtar me fuqi të plotë provuese, por nuk mbështeten nga asnjë provë e administruar gjatë hetimit administrativ. Cenimi i besimit të publikut përbën një përfundim të deklaruar vetëm në vendimin përfundimtar dhe kjo përbën shkelje të rëndë procedurale dhe shkelje të procesit të rregullt ligjor, pasi ankuesi nuk ka pasur mundësi të mbrohet ndaj këtij përfundimi që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të vendosur ndaj tij nga shumica e Komisionit.
72. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit të Komisionit dhe pretendimet e ankuesit, konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

72.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Kam blerë në vitin 2009, një automjet tip "Mercedes Benz", me kontratë noteriale. Automjeti është me targë {***}. Të gjitha pagesat e mjetit, blerje mjeti plus doganë, i ka kryer shitësi B. M. Unë kam paguar vetëm detyrimet te KSHA-ja (taksa etj.). Vlera: 400.000 lekë. Kontratë noteriale, datë 24.8.2009. E kam shitur automjetin tip "Mercedes Benz", me targë {***}, në vitin 2011, me kontratë noteriale, datë 7.4.2011. Vlera: 1.000.000 lekë.*

72.2. Në DIPP-2009, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit me vlerë 400.000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për krijimin e tij. Në DIPP-2011, në ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar shitjen e automjetit për një vlerë 1.000.000 lekë.

72.3. Nga informacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja³³, rezultoi se nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 24.08.2009, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin "Daimler Crysler" E 220 CDI nga shtetasi B. M., në vlerën 400.000 lekë. Certifikata e kontrollit fizik të mjetit është lëshuar në datën 26.08.2009 dhe certifikata e pronësisë në emër të subjektit për këtë automjet, është lëshuar në datën 11.10.2009, të dy dokumentet janë lëshuar nga DSHTRR-ja Vlorë.

³³ Shkresa kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 10.01.2020.

72.4. Referuar dokumenteve³⁴, automjeti ka hyrë në territorin shqiptar në datën 05.07.2009, dhe në datën 11.07.2009³⁵ janë kryer procedurat e zhdoganimit të tij, si dhe është paguar detyrimi doganor në shumën prej 259.950 lekësh. Sipas deklaratës doganore, çmimi i automjetit është 268.058 lekë (2.000 euro). Rezulton se për blerjen dhe zhdoganimin e automjetit, në korrik të vitit 2009, shtetasi B. M. ka shpenzuar shumën 528.008 lekë (pa përfshirë shpenzimet e transportit).

72.5. Referuar kontratës së shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 07.04.2011, subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë automjet te shtetasi D. A., në vlerën 1.000.000 lekë. DPSHTRR-ja konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin me targë VL 9500 C, për periudhën kohore 27.08.2009 – 04.03.2014, pra, ky automjet ka qenë në emër të subjektit edhe pas shitjes së tij në vitin 2011, për një afat 3-vjeçar, dhe subjekti nuk e ka deklaruar³⁶ këtë fakt në DPV-të përkatëse.

72.6. Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë objekt kontrolli, subjekti i ka deklaruar si burim krijimi për pagesën e këstit të radhës të shoqërisë ndërtuese për apartamentin e blerë në në Yzberisht, Tiranë.

72.7. Në lidhje me vlerën e blerjes dhe shitjes, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se makina, në çastin e blerjes, ka qenë me defekt në motor. Vjehri i tij është me profesion mekanik dhe, në çastin e blerjes, ka folur me të duke i kërkuar mendim nëse mjeti mund të rregullohej duke e kthyer në gjendje të mirë teknike, duke i vendosur pjesë të reja mekanike. Pasi mori miratimin e tij, ka filluar riparimin e mjetit, veprim për të cilin është angazhuar edhe vjehri. Sipas subjektit, për shërbimet e kryera, shuma e shpenzimeve ka qenë rreth 160.000 lekë. Gjithashtu, shpenzime ka kryer edhe për efekt të regjistrimit të automjetit. Në vijim, subjekti ka pretenduar se vlera e automjetit u rrit jo vetëm me riparimin e defektit në vitin 2009, por edhe me shërbimet dhe përmirësimet që iu bënë makinës edhe më pas, duke zëvendësuar pjesët e vjetra me të reja. Makina u shit pas 1 viti e 7 muaj që e kishte blerë dhe, në këtë periudhë, ajo nuk ishte përdorur shumë nga ana e familjes së tij, ndaj i ruajti vlerat e saj pas përmirësimit.

72.8. Në lidhje me pronësinë e automjetit pas shitjes dhe mosdeklarimin e përdorimit të tij, subjekti ka deklaruar se ky automjet nuk është përdorur nga ana e tij, pasi vetë shtetasi D. A., nga data që ka mbaruar siguracioni në emrin e subjektit (tetor 2011), ka siguruar³⁷ automjetin në emrin e tij, konfirmuar edhe nga vërtetimi i lëshuar nga shoqëria e sigurimit “Sigma Interbalkanian”, ku vërtetohet faktin se shtetasi D. A. ka siguruar mjetin me targë {***}, me nr. shasie {***}, për periudhën 12.10.2011 - 11.10.2012, si edhe nga shoqëria e sigurimeve

³⁴ Vërtetimi nr. {***}, datë 05.07.2009, lëshuar nga Dogana Vlorë dhe vërtetimi nr. {***} regj., datë 16.07.2009, lëshuar nga Stacioni i Policisë Kufitare Port, përcjellë nga DPSHTRR-ja.

³⁵ Referuar deklaratës doganore IM 4, me numër reference {***}, përcjellë nga DPSHTRR-ja.

³⁶ Në zbatim me parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

³⁷ Subjekti ka dorëzuar në cilësinë e provës: (i) vërtetimin e datës 18.06.2021, nga shoqëria “Sigma Interbalkanian” ShA (dega Vlorë); (ii) vërtetimin e datës 18.06.2021, nga Instituti i Sigurimeve INSIG (dega Vlorë).

“INSIG” konfirmohet se shtetasi D. A. ka siguruar mjetin me targë {***}, për periudhën 30.10.2012 - 29.10.2013.

73. Nga të gjitha faktet dhe rrethanat e pasqyruara më lart, trupi gjykues konstaton se deklaratimet e subjektit, sa i takon gjendjes teknike të automjetit në kohën e blerjes, nuk janë në përputhje me dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR-ja, pasi nga certifikata e kontrollit fizik e datës 26.8.2009, nuk janë konstatuar defekte teknike dhe as në kontratën e shitjes nuk është paraqitur një fakt i tillë. Po ashtu, mbeten deklarative dhe të paprovuara pretendimet e subjektit në lidhje me riparimin dhe përmirësimin e automjetit. Shitja e këtij automjeti në vitin 2011, në vlerën 1.000.000 lekë, nuk justifikohet as me shpenzimet e pretenduara nga subjekti për riparimin e tij dhe çmimi i vendosur në kontratë është disproporcional në raport me çmimin e blerjes dhe me faktet që konfirmohen nga provat e administruara. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se shuma e pretenduar si e përfituar nga diferenca e çmimit të shitjes me çmimin e blerjes së këtij automjeti, nuk mund të përfshihet si burim krijimi në pasuritë vijuese të subjektit të rivlerësimit, por duhet të përfshihet vetëm vlera prej 400.000 lekësh³⁸, e barabartë me çmimin e blerjes.

74. Sa i takon konkluzionit të Komisionit lidhur me cenimin e besimit të publikut te drejtësia, trupi gjykues vlerëson se kjo situatë faktike, në ndryshim nga Komisioni, nuk duhet të kualifikohet sipas nenit 61, pika 5 e këtij ligji, por u mbajt në konsideratë në kuadër të vlerësimit të besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit për vlerësimin e kriterit të pasurisë në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 90,9 m², të ndodhur në Yzberisht, Tiranë:*

75. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 90,9 m², të ndodhur në Yzberisht, Tiranë, ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

76. Këtë vlerësim, Komisioni e ka bazuar në konstatimet se: (i) deklarimi i bërë nga subjekti në DPV-në e vitit 2009, se në këtë vit ka paguar 7.000 euro për shoqërinë ndërtuese, nuk gjen pasqyrim në kontratën e porosisë të datës 2.2.2010, sipas së cilës kësti i parë prej 10.000 eurosh, është paguar në datën 2.2.2010; (ii) shuma 3.000 euro e deklaruar si dhuratë nga kunati i subjektit, z. D. LL., nuk është deklaruar si burim për blerjen e apartamentit në deklaratën *vetting* dhe deklaratat periodike vjetore, dhe transfertat nga ky shtetas fillojnë pas datës 2.2.2010, në të cilën është paguar shuma 10.000 euro, duke e bërë të pamundur përdorimin e tyre për pagimin e kësaj shume; (iii) subjekti i rivlerësimit ka pasur pamundësi financiare për

³⁸ Nga verifikimi i analizës financiare të Komisionit, për vitin 2009, në zërin “Pasuri”, në krah të përshkrimit *autoveturë “Daimler Chrysler” E220CDI, blerë në datën 24.08.2009, në shumën 400.000 lekë, shitur me kontratë në datën 07.04.2011, në shumën 1.000.000 lekë, Komisioni ka vendosur vlerën 400.000 lekë. Komisioni nuk e ka ngarkuar subjektin me shpenzime për shërbimet e kryera dhe shitjen e automjetit në vitin 2011, e pasqyruar si zbritje 400.000 lekë, duke konsideruar si të barabartë çmimin e blerjes në vitin 2009, me çmimin e shitjes në vitin 2011.*

pagimin e këstit të parë në shumën 10.000 euro në datën 2.2.2010; (iv) për sa i përket përfshirjes së të ardhurave të pretenduara nga kontrata e kaparit, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të merren në konsideratë si burim krijimi në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016; (v) lidhur me të ardhurat e pretenduara nga shitja e automjetit në vitin 2011, subjekti ka dështuar të provojë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të merren në konsideratë si burim krijimi në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

77. Subjekti i rivlerësimit e ka bazuar shkakun e ankimit, me të cilin kundërshton konkluzionet e Komisionit si të arritura në kundërshtim me provat, të paragjykuara dhe të paracaktuara në pretendimet se Komisioni: (i) nuk ka marrë në konsideratë pagesën në shumën 7.000 euro të kryer në vitin 2009, të cilën e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 dhe konfirmohet nga mandatpagesa e lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK; (ii) nuk i pasqyron pagesat sikurse janë kryer dhe deklaruar prej tij, por duke i spostuar ato, krijon artificialisht balancë negative në analizën financiare; (iii) në vitin 2010 duhet të përfshinte vetëm pagimin e shumës 7.000 euro; (iv) nuk ka përfshirë si burim ndihmën që i ka dhënë kunati D. LL. deri më datë 02.02.2010, pasi ajo i është dhënë gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri nga data 11.01.2010 deri më 18.01.2010; (v) në pagesën e këstit në vitin 2011, në shumën 12.000 euro, duhet të përfshinte shumën 3.000 euro të dhuruar nga kunati dhe të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit “Daimler Chrysler E220 CDI” në vitin 2011, në shumën 700.000 lekë, pasi në vitet 2009-2010 ka shpenzuar rreth 300.000 lekë për riparimin e tij; (vi) në pagesën e këstit në vitin 2013, në shumën 5.800 euro, duhet të përfshinte si burim edhe shumën 30.000 euro të përfituar nga kontrata e kaparit për shitjen e apartamentit në Vlorë.

78. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e ankuesit, konstatoi si më poshtë.

78.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Kam porositur në vitin 2009 një banesë në Yzberisht, Tiranë, me sipërfaqe 90,9 m². Kontratën e porosisë noteriale e kam bërë në vitin 2010. Kontrata përfundimtare me firmën është bërë në vitin 2015. Është regjistruar pasuria në ZVRPP. Vlera: 31.815 euro. E kam shitur këtë banesë në vitin 2015 me kontratë noteriale, shtetasit N. A.. Pasuria duhet të ketë kaluar në emër të blerësit në ZVRPP. Shuma prej 35.000 eurosh ka kaluar me bankë. Bashkëlidhur dokumenti. Vlera: 35.000 euro. Kontratë noteriale, datë 10.2.2015.* Në këtë deklaratë, subjekti nuk e ka treguar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

78.2. Në DIPP-2009, subjekti ka deklaruar: *Kam porositur apartament me sip. 90,9 m², në {***}, komuna {***}, Tiranë, me çmim 350 euro/m², në vlerën 31.815 euro. Kam paguar nga shuma që i detyrohem firmës, 7.000 euro. Kontratën e porosisë e kam bërë me firmën në vitin 2010, por do e paraqes deklarin e ardhshëm.* Në këtë deklaratë, subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të shumës 7.000 euro, ndërsa në rubrikën “Detyrimet financiare”, detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë është deklaruar në shumën 24.815 euro. Në të dhëna konfidenciale (dhurata dhe trajtime preferenciale), subjekti ka deklaruar se: *më ka dhuruar kunati D. LL. një shumë rreth 4.500 euro.*

78.3. Në DIPP-2010, subjekti ka deklaruar se: *Gjatë vitit 2010, kam përpiluar para noterit kontratën e porosisë për një apartament me sip. 90,9 m², me vendndodhje në {***}, me çmim 350 euro/m². Siç e kam deklaruar, apartamentin e kam porositur që në vitin 2009 dhe gjatë 2009 i kam likuiduar firmës 7.000 euro. Gjatë vitit 2010, i kam dhënë firmës 7.000 euro dhe i detyrohem shoqërisë së ndërtimit edhe 17.815 euro. Në të dhënat konfidenciale (dhurata dhe trajtime preferenciale) subjekti ka deklaruar se: më ka dhuruar kunati D. LL. një shumë rreth 3.000 euro.*

78.4. Në DIPP-2011, subjekti ka deklaruar: *Gjatë vitit i kam dhënë firmës së ndërtimit shumën 12.000 euro për ap. me sip. 90,9 m², detyrimi i mbetur në shumën 5.185 euro. Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale (dhurata dhe trajtime preferenciale)”, ka deklaruar se: më ka dhuruar kunati im një shumë rreth 3.000 euro.*

78.5. Në DIPP-2012, subjekti ka deklaruar se i detyrohet firmës, shumën 17.815 euro, për banesën që ka prenotuar në {***}, Tiranë.

78.6. Në DIPP-2013, subjekti ka deklaruar se: *I kam dhënë firmës së ndërtimit gjatë vitit 2013, për banesën që kam prenotuar në {***} të Tiranës, shumën 12.000 euro. I mbetem pa shlyer edhe 5.815 euro.*

78.7. Në DIPP-2015, subjekti ka deklaruar: *Kam shitur banesën në {***}, Tiranë, me sip. 77,2 m². Vlera: 35.000 euro. Shuma prej 35.000 eurosh, e depozituar te Banka Raiffeisen gjatë vitit 2015, që rrjedh nga shitja e banesës në {***}, është pakësuar e gjitha pasi ka kaluar te firma e ndërtimit “{***}”.*

78.8. Sipas kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 2.2.2010, subjekti i rivlerësimi ka porositur te sipërmarrësi, shoqëria “{***}” ShPK, ndërtimin e apartamentit nr. {***}, me sip. 90,9 m², në {***}, komuna {***}, Tiranë, kundrejt çmimit 31.815 euro. Në lidhje me likuidimin e çmimit të këtij apartamenti, në këtë kontratë është parashikuar se: (i) kësti i parë në shumën 10.000 euro u pagua me lidhjen e kontratës jashtë zyrës së noterisë; dhe (ii) pjesa e mbetur do të paguhet me këste mujore pranë shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën 300 euro/muaj.

78.9. Në kontratën e shitjes së apartamentit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.2.2015, referohet se çmimi i shitjes 31.815 euro, është likuiduar totalisht sipas kushteve të kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 2.2.2010, dhe se apartamenti është marrë në dorëzim dhe shfrytëzohet nga pala blerëse që në ndërtimin e godinës dhe likuidimin e çmimit.

78.10. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë dokumentacionin ligjor provues lidhur me shlyerjet e kësteve të apartamentit dhe detyrimet e mbetura ndaj firmës ndërtuese, si dhe të deklarojë burimin e krijimit për pagesat e shlyera. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se: *[...] sipas mandatarkëtimeve, kundrejt firmës rezulton se kam bërë pagesa nga viti 2009-2013, në shumën 31.800 euro. Në këto kushte, nuk kam më asnjë detyrim ndaj firmës ndërtuese përkatëse [...]. Në këtë rast, jemi përpara një pasqyrimi të pasaktë të të dhënave nga ana ime sepse në DIPP-në e vitit 2013, kam bërë një gabim, nga 12.000 euro që kam deklaruar që i kam dhënë firmës, në fakt i kam dhënë 5.800 euro, që përbën edhe këstin*

e fundit sipas dokumentacionit që kam paraqitur. Për pagesat periodike ndaj firmës, rezulton se: (i) për vitin 2009, kam paguar 7.000 euro; (ii) për vitin 2010, kam paguar 7.000 euro; (iii) për vitin 2011, kam paguar 12.000 euro; (iv) për vitin 2013, kam paguar 5.800 euro. Këto shuma janë të barabarta me çmimin e përgjithshëm të sendit të blerë. Te deklarimi periodik, në vend që të deklaroja se për vitin 2013 kam paguar 5.800 euro³⁹, gabimisht kam deklaruar 12.000 euro. Si burim krijimi i të ardhurave për pagesën e këstit të fundit, janë kursimet nga pagat dhe të ardhurat nga shitja e banesës në Vlorë. Me qëllim vërtetimit të pagesës së të gjithë çmimit të apartamentit të porositur, në vlerën totale 31.815 euro, subjekti u ka bashkëlidhur përgjigjeve për pyetësonin nr. 2, një shkresë nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, shoqëruar me kopje të disa mandatarkëtimeve.

79. Lidhur me pretendimin e ankuesit se kësti i parë prej 7.000 eurosh për këtë pasuri, është paguar në vitin 2009, nga aktet e fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se, referuar kontratës së porosisë, kësti i parë është deklaruar i paguar më datë 02.02.2010. Megjithëse subjekti këtë fakt e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009, ky pretendim bie në kundërshtim me sa palët kanë deklaruar në kontratën e porosisë në vitin 2010⁴⁰. Referuar datës së nënshkrimit të kontratës së porosisë, 02.02.2010, dhe datës 15.03.2010 kur është dorëzuar DIPP-2009, konstatohet se në një kohë kaq të shkurtër, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të ndryshme sa i takon pagesës së këstit të parë dhe, nëse do të ishte i vërtetë fakti se ky këst është kryer në vitin 2009, kjo pagesë duhet të gjente pasqyrim në kontratën e porosisë së nënshkruar më datë 02.02.2010. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se kjo pagesë është saktësuar pranë ILDKPKI-së sipas sqarimit të datës 27.09.2010, dhe se provohet nëpërmjet informacionit dhe mandatpagesës së përcjellë nga shoqëria “{***}” ShPK⁴¹, nga analiza e dokumentacionit, trupi gjykues vëren se, në shpjegimet e datës 27.09.2010 pranë ILDKPKI-së, subjekti ka shpjeguar se, në kontratën e porosisë është vendosur vlera e shlyerjes prej 10.000 eurosh, nga të cilat 7.000 euro u përkasin të ardhurave të vitit 2009, ndërsa pjesa tjetër prej 3.000 eurosh u takon të ardhurave të vitit 2010, por nuk ka sqaruar kohën e kryerjes së kësaj pagese dhe, po ashtu, nuk rezulton t’u ketë bashkëlidhur këtyre sqarimeve akte provuese sa i takon shlyerjes së këtij kësti pranë shoqërisë. Nga ana tjetër, megjithëse subjekti pretendon se vlera prej 7.000 eurosh është nga të ardhurat e vitit 2009, në DIPP-në e këtij viti, nuk rezulton të ketë deklaruar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e kësaj shume. Mandatpagesat⁴², të cilat pretendohet të jenë mbajtur nga shoqëria “{***}” ShPK për shlyerjen e kësteve, paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision, vlerësohen të pamjaftueshme për të provuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me kohën e shlyerjes së çmimit të kësaj pasurie, pasi jo vetëm që këto mandatpagesa paraqiten për herë të

³⁹ Në procesverbalin e datës 28.01.2016 të ILDKPKI-së, subjekti ka shpjeguar se, në deklaratimet 2012 dhe 2013, janë bërë lapsuse nga ana e tij për shkak të përdorimit të komandave copy-paste në kompjuter. Subjekti ka sqaruar se në vitin 2012 nuk ka shlyer pjesë nga detyrimi, ndërsa në vitin 2013 ka shlyer të gjithë vlerën e mbetur të detyrimit që ka qenë 5.815 euro.

⁴⁰ Kësti i parë prej 10.000 eurosh u pagua sot me lidhjen e kontratës jashtë zyrës noteriale.

⁴¹ Sipas shkresës së datës 9.02.2021 dhe shkresës së datës 24.6.2021.

⁴² Referuar shkresës së datës 09.02.2021, të shoqërisë “{***}” ShPK, janë bashkëlidhur disa mandatpagesa, të cilat nuk përmbajnë emër të përfaqësuesit dhe vulën e shoqërisë.

parë gjatë hetimit administrativ, por ato kanë vlerë të kufizuar provuese në krahasim me deklarin në kontratën e porosisë⁴³ të nënshkruar para noterit.

80. Sqarimet e subjektit pranë ILDKPKI-së dhe informacioni i përcjellë nga shoqëria “{****}” ShPK paraqesin një realitet të ndryshëm dhe në kundërshtim me përcaktimet në kontratën e sipërcituar, e cila përbën një akt juridik me fuqi të plotë provuese. Mbi këtë konstatim, arrihet në përfundimin se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me shlyerjen e këstit të parë, nuk mbështeten në fakte e prova dhe ky këst duhet të përlllogaritet i shlyer në vitin 2010, sipas parashikimeve në kontratën e porosisë.
81. Trupi gjykues e gjeti të drejtë konstatimin e Komisionit se subjekti për këtë apartament ka paguar në total 31.800 euro, dhe pagesat e kësteve të çmimit janë paguar si vijon: (i) 14.000 euro⁴⁴ në vitin 2010; (ii) 12.000 euro⁴⁵ në vitin 2011; dhe (iii) 5.800 euro në vitin 2013. Me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës prej 10.000 eurosh në datën 02.02.2010, trupi gjykues verifikoi nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare për periudhën 01.01.2010 – 02.02.2010, duke konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, sa i takon pagesës së këstit 10.000 euro në datën 02.02.2010. Në lidhje me pjesën tjetër të pagesave për vitin 2010, të cilat duket se janë kryer në periudhën gusht – dhjetor 2010 (në total 4.000 euro), dhe për të cilat subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të tyre, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e shumës 4.000 euro gjatë periudhës 03.02.2010 – 31.12.2010, si edhe për kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë.
82. Lidhur me pretendimin e ankuesit për përfshirjen në analizë financiare të dhuratës nga kunati D. LL., në shumën 3.000 euro, për pagesën në datë 02.02.2010, trupi gjykues konstatoi se si në deklarinet periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri. Për sa më sipër, konstatohet se deklarimi i kësaj pasurie në deklaratën *vetting*, nuk është kryer në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, parashikimet⁴⁶ e të cilit kanë qenë të qarta dhe eksplicite, sa i takon përcaktimit të detyrimit

⁴³ Në nenin 690 të Kodit Civil, parashikohet se: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”. Ndërsa në nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarinave që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”.

⁴⁴ Referuar kontratës së porosisë, shuma 10.000 euro është paguar në datën 02.02.2010, ndërsa shuma 4.000 euro gjatë vitit.

⁴⁵ Në referencë të deklarinave në DPV-në e vitit 2011, si dhe mandatarkëtimet e dërguara nga shoqëria ndërtuese (1.000.000 lekë + 4.900 euro).

⁴⁶ Referuar legjislacionit në fuqi lidhur me detyrimin për deklarim të pasurive dhe interesave privatë në kuadër të procesit të rivlerësimit, si dhe të mënyrës së deklarinimit sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në pikat 1, 2 dhe 3 të tij, në nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të të njëjtit ligj, në të cilën, në informacionin e dhënë në ndihmë të subjekteve deklaruuese, në

për deklarimin e burimit të krijimit të secilës prej pasurive, duke e bërë deklarimin e subjektit për këtë pasuri, të pasaktë në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se në deklaratat periodike vjetore të viteve 2008 – 2011, subjekti ka deklaruar dhurimin nga kunati në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, të vlerave përkatësisht 3.500 euro, 4.500 euro, 3.000 euro dhe 3.000 euro, por në asnjë vit nuk ka deklaruar shtim apo pakësim të gjendjes së kursimeve *cash*, si edhe nuk ka deklaruar përdorimin e këtyre shumave për krijimin e ndonjë pasurie apo për shpenzime të tjera. Nga kontrolli i veprimeve të *MoneyGram*, rezulton se transfertat nga shtetasi D. LL., në favor të subjektit të rivlerësimit, fillojnë pas datës 02.02.2010 kur është bërë pagesa e këstit të parë prej 10.000 eurosh (transferta e parë i përket datës 13.02.2010, në shumën 400 euro). Shuma totale e transfertave të dërguara (6 transfertat) nga z. LL. për vitin 2010, është në vlerën 2.450 euro⁴⁷ dhe jo 3.000 euro sa ka pretenduar subjekti. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen e dhurimit të pretenduar në shumën 3.000 euro si burim për pagesën e këstit të parë prej 10.000 eurosh në datën 02.02.2010. Në përfundim të vlerësimit për pagesën e këstit të parë, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të Komisionit nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, konstatoi se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagesën e shumës 10.000 euro në datën 02.02.2010 në vlerën (-) 1.320.234 lekë.

83. Lidhur me pretendimin e subjektit se në lidhje me pagesën e këstit prej 12.000 eurosh në vitin 2011, në analizën financiare duhet të përfshihen edhe dhurimet nga kunati në shumën 3.000 euro gjatë vitit 2011, përveç sa u konstatua më lart lidhur me mungesën e deklarimit të këtij burimi, trupi gjykues konstatoi se, referuar dërgesave me *MoneyGram* të shtetasis D. LL. për

pjesën që i takon deklarimit të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, thuhet shprehimisht: “Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit të rivlerësimit dhe të familjes së tij [...], burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit, përfshirë interesat privatë që i ka në pronësi ose në përdorim, sipas nenit 3, pikat 9 dhe 11 të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në faqen 5 të së njëjtës shtojcë të ligjit nr. 84/2016, që përbën edhe formularin e deklaratës së pasurisë vetting, subjektet e rivlerësimit, në kuadër të deklarimit të pasurive dhe interesave të tyre privatë, udhëzohen shprehimisht si vijon: “Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën [...] pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloji pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë”. Referuar nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, duhet të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Gjithashtu, në pikën 7 të udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet shprehimisht: “Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojnë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre”.

⁴⁷ (i) Datë 13.02.2010, shuma 400 euro, dërgues D. LL. dhe marrës Dritan Marku; (ii) datë 07.03.2010, shuma 400 euro, dërgues D. LL. dhe marrës Dritan Marku; (iii) datë 18.04.2010, shuma 450 euro dërgues D. LL. dhe marrës Dritan Marku; (iv) datë 16.05.2010, shuma 400 euro, dërgues D. LL. dhe marrës Dritan Marku; (v) datë 04.10.2010, shuma 400 euro, dërgues D. LL. dhe marrës Dritan Marku; (vi) datë 21.12.2010, shuma 400 euro, dërgues D. LL. dhe marrës Dritan Marku.

subjektin e rivlerësimit Dritan Marku për vitin 2011, ato rezultojnë në shumën 2.000 euro⁴⁸ dhe jo 3.000 euro, sikurse ka pretenduar subjekti i rivlerësimit. Për më tepër, dy prej transfertave, konkretisht transfertat e datës 9.05.2011, rezultojnë me dërgues E. M., marrës D. LL., shuma 550 euro, dhe transfertat e datës 15.05.2011 ka si dërgues Dritan Marku, marrës D. LL., shuma 300 euro.

84. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizë financiare të të ardhurave nga shitja e automjetit të tipit “Mercedes Benz”, në vitin 2011, referuar arsyetimit dhe analizës së kësaj pasurie më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerësoi se nga shitja e automjetit, pranohet e përfituar vetëm shuma 400.000 lekë, e njëjtë me çmimin e blerjes, dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim se, nga shitja e automjetit, duhet të njihet së paku shuma 700.000 lekë sipas çmimit të blerjes dhe shërbimeve të kryera në shumën 300.000 lekë, bie në kundërshtim me sa ai vetë ka pretenduar gjatë hetimit administrativ, si dhe me shpjegimet e tij në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, ku ka deklaruar se për riparimet e automjetit, ka shpenzuar rreth 160.000 lekë, të cilat mbeten gjithsesi të paprovuara.
85. Në përfundim të vlerësimit për pagesën e kështit prej 12.000 eurosh gjatë vitit 2011, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të Komisionit nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, konstatoi se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagesën e kështit dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë vit, në vlerën (-) 684.463 lekë.
86. Lidhur me pretendimin e subjektit se, për pagesën e kështit në vitin 2013 në shumën 5.800 euro, të ndarë në disa pagesa të kryera në periudhën 04.11.2013 - 23.12.2013, kanë shërbyer si burim të ardhurat nga pagat dhe nga shitja e apartamentit në Vlorë, trupi gjykues, në vijim të analizës së bërë më sipër në këtë vendim, lidhur me të ardhurat e ankuesit nga kontrata e kaparit, e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit për mospërfshirjen e tyre si burim financiar i ligjshëm. Në përfundim të vlerësimit për pagesën e kështit, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të Komisionit nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, konstatoi se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagesën dhe për të justifikuar kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për vitin 2013, në vlerën (-) 2.791.957 lekë.
87. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues arrin në përfundimin se, lidhur me pasurinë “apartament banimi” me sipërfaqe 90,9 m², të ndodhur në {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

⁴⁸Transfertë, datë 31.05.2011, marrës E. M., dërgues D. LL., shuma 350 euro; transfertë, datë 12.02.2011, marrës Dritan Marku, dërgues D. LL., shuma 500 euro; transfertë, datë 19.03.2011, marrës Dritan Marku, dërgues D. LL., shuma 350 euro; transfertë, datë 19.04.2011, marrës Dritan Marku, dërgues D. LL., shuma 400 euro; transfertë, datë 9.05.2011, dërgues E. M., marrës D. LL., shuma 550 euro; transfertë, datë 15.05.2011, dërgues Dritan Marku, marrës D. LL., shuma 300 euro; transfertë, datë 12.11.2011, marrës Dritan Marku, dërgues D. LL., shuma 400 euro.

➤ *Lidhur me pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sipërfaqe 89 m², në Tiranë:*

88. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit lidhur me pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sipërfaqe 89 m², në Tiranë se: *subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
89. Këtë vlerësim, Komisioni e ka bazuar në konkluzionet se: *sa i përket përfshirjes së të ardhurave të pretenduara nga kontrata e kaparit, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, pretenduar si të përfituara nga marrëdhënia e kaparit mbi apartamentin në Vlorë dhe nuk ka arritur të provojë në këtë mënyrë, ligjshmërinë e këtyre të ardhurave dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përfshijë shumën prej 30.000 eurosh, përfitur nga kontrata e kaparit, si burim krijimi për këtë pasuri dhe, referuar përfundimeve të arritura, lidhur me të ardhurat për apartamentin e shoqërisë “{***}” ShPK në vitin 2015, konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimet e ligjshme financiare për pagesën e çmimit të blerjes së këtij apartamenti në shumën 55.000 euro.*
90. Gjithashtu, Komisioni ka mbajtur në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit, si burim financiar për krijimin e kësaj pasurie, ka deklaruar edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë apartament banimi në {***}, Tiranë, për të cilin ai rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tij.
91. Subjekti i rivlerësimit e ka bazuar shkakun e ankimit në pretendimet se është provuar bindshëm burimi i përfitur nga kontrata e shitjes së apartamentit në Vlorë, ndërkohë që edhe për apartamentin në {***} nuk rezultojnë mungesa burimesh financiare, pasi të ardhurat janë të ligjshme dhe të mjaftueshme për të justifikuar këto pagesa. Nga analiza financiare, nuk duhet të konstatohen diferenca pasi, me lekët e përfituara nga shitja e secilës pasuri, subjekti ka blerë apartamentin nga shoqëria “{***}” ShPK, pa përdorur asnjë burim tjetër në kryerjen e pagesave.
92. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e ankuesit, konstaton si më poshtë.
- 92.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Kam blerë në Tiranë nga shoqëria “{***}” ShPK, një shtëpi banimi me sipërfaqe 89 m², vlera: 55.000 euro. Kontratë noteriale, datë 4.5.2015. Banesën e kam likuiduar plotësisht gjatë vitit 2016, shuma prej 35.000 eurosh për blerjen e kësaj banese, janë nga shitja e banesës në {***}, Tiranë, ndërsa shuma prej 20.000 eurosh, janë nga shitja e banesës në Vlorë, të depozituara tek Intesa Sanpaolo Bank.*
- 92.2. Në DIPP- në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *Kam blerë në Tiranë, nga firma “{***}” ShPK, një shtëpi banimi me sip. 89 m², për shumën 55.000 euro. Shuma prej 35.000 eurosh, e depozituar te Raiffeisen Bank gjatë vitit 2015, që rrjedh nga shitja e banesës në {***}, është*

*pakësuar e gjitha, pasi ka kaluar te firma e ndërtimit “{***}”⁴⁹. Shuma prej 20.000 eurosh, e depozituar në vitin 2013 tek Intesa Sanpaolo Bank, është pakësuar me 15.000 euro, pasi kjo shumë ka kaluar te firma “{***}”. Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: *I detyrohem firmës së ndërtimit “{***}” ShPK për banesën që kam blerë në Tiranë, shumën prej 5.000 eurosh.**

92.3. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar shlyerjen e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën 5.000 euro, me të ardhura nga shuma e depozituar te Banka Intesa Sanpaolo.

92.4. Sipas kontratës së porosisë nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 4.5.2015, me palë sipërmarrës shoqërinë “{***}” ShPK dhe porositës subjektin e rivlerësimit, është porositur apartamenti {***} (2+1) me sip. totale 105 m², kati i 5-të i banimit, në vlerë totale 55.000 euro. Referuar nenit 2 të kësaj kontrate, mënyra e pagesës është dakordësuar mes palëve si vijon: *shuma 50.000 euro do të paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe diferenca 5.000 euro do të likuidohet deri në maj të vitit 2016.*

92.5. Referuar të dhënave nga Intesa Sanpaolo Bank, rezulton se nga llogaria në euro nr. {***}, në emër të subjektit të rivlerësimit, në datën 5.5.2015, është transferuar për shoqërinë “{***}” ShPK, shuma 15.000 euro me përshkrim “Blerje apartamenti”, ndërsa në datën 27.5.2016, është transferuar për këtë shoqëri edhe shuma 5.000 euro, me përshkrimin “Pagesë kësti për blerje apartamenti”.

93. Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi, është ngushtësisht i lidhur me vlerësimin që ai ka bërë për të ardhurat e pretenduara nga shitja e pasurisë apartament me sipërfaqe 90,9 m² në {***}, Tiranë, dhe të ardhurat e pretenduara nga shitja e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 103,07 m² në Vlorë. Në vijim të konkluzioneve që trupi gjykues ka arritur më lart në këtë vendim për dështimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar përfitimin e të ardhurave të ligjshme nga kontrata e kaparit për apartamentin në Vlorë dhe për pamjashtueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament banimi në {***}, Tiranë, në përfundim gjendet i drejtë vlerësimi i Komisionit për pasurinë “*apartament banimi*”, me sipërfaqe 89 m², ndodhur në Tiranë, se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Në lidhje me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 94,65 m², në Vlorë:*

94. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim si të gabuar vlerësimin e Komisionit në lidhje me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 94,65 m², në Vlorë, se: *subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe përpjekja e subjektit të rivlerësimit*

⁴⁹ Nga të dhënat e Raiffeisen Bank, rezulton se, nga llogaria në euro nr. {***}, në emër të subjektit të rivlerësimit, në datën 5.5.2015, është transferuar për shoqërinë “{***}” ShPK, shuma 35.000 euro me përshkrim: “Pagesë e këstit të parë, sipas kontratës së porosisë nr. {***} për blerje apartamenti”.

për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave, të cilat do ta shpëtonin nga situata që lidhet me justifikimin e burimeve të ligjshme të kësaj pasurie të tij, e vendosin subjektin në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61, si dhe të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

95. Këtë vlerësim, Komisioni e ka bazuar në konstatimet se: (i) subjekti i rivlerësimit ka dështuar të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të përfituara nga marrëdhënia e kaparit për apartamentin në Vlorë dhe, për rrjedhojë, nuk ka arritur të provojë në këtë mënyrë ligjshmërinë e të ardhurave të përdorura për pagesën e kryer për këtë apartament në vitin 2014; (ii) në lidhje me shumën prej 5.000 eurosh, të paguar në datën 05.04.2015, si pjesë e çmimit të blerjes/porositjes së këtij apartamenti, për të cilën, subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka pretenduar se vjen nga një hua e marrë nga vjehri P. LL., në kushtet kur kjo hua, e pretenduar dhe e papërcaktuar në vlerë dhe në kohë, nuk është deklaruar nga subjekti në DIPP-2015 dhe as në deklaratën *vetting* si burim për blerjen e kësaj pasurie, deklarimi i subjektit është përpjekje për të justifikuar diferencën negative të rezultuar dhe nuk mund të përfshihet në analizën e treguesve financiarë si burim krijimi për këtë pasuri; (iii) subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pasaktë, për sa kohë nga analiza e rrethanave faktike, si më sipër, është e pamundur të arrihet në një konkluzion të qartë dhe bindës se cilat janë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit që përputhen me situatën e vërtetë faktike lidhur me krijimin e kësaj pasurie.
96. Subjekti i rivlerësimit e ka bazuar shkakun e ankimit në pretendimet se: (i) në analizën financiare, duhet të përfshihen të ardhurat nga shitja e një pasurie të cilën ai e ka blerë në mënyrë të rregullt dhe e ka shitur, duke mos e disponuar më atë dhe se po ashtu ka arritur të provojë burimin e të ardhurave të shtetasit A. D., blerësit të kësaj pasurie; (ii) analiza financiare për vitin 2014, duke përfshirë shumën e arkëtuar nga shtetasi A. D., rezulton pozitive, çka evidenton faktin se ankuesi ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën 20.000 euro për blerjen e këtij apartamenti; (iii) pagesa e kryer më datë 05.04.2015, në shumën 5.000 euro, ka si burim një hua të marrë nga vjehri në kohën kur jetonte në të njëjtën banesë dhe, megjithëse nuk e ka deklaruar këtë fakt si veprim i kryer brenda vitit, vjehri i tij ka pasur mundësi për dhënien e kësaj huaje.
97. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e ankuesit, konstaton si më poshtë.
- 97.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Kam prenotuar një banesë në Vlorë, me sip. 94,65 m², te shoqëria “{***}” ShPK. Për këtë, kam bërë një kontratë shitblerjeje paraprake te noteri në datën 4.11.2014. I kam likuiduar firmës 25.000 euro, të cilat janë nga shitja e banesës në Vlorë dhe nga kursimet e mia. I detyrohem shoqërisë së ndërtimit edhe 5.000 euro. Vlera: 30.000 euro.*
- 97.2. Në DIPP-2014, subjekti ka deklaruar: *kam prenotuar një banesë në Vlorë, me sip. 94,65 m², në shumën 30.000 euro. Kontrata e shitblerjes paraprake te noteri, datë 4.11.2014. Ndërsa në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka deklaruar se: I detyrohem firmës së ndërtimit për banesën që kam prenotuar në Vlorë, shumën 10.000 euro.*

97.3. Në DIPP-2015, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar se: *I detyrohem firmës së ndërtimit “{***}” ShPK, për banesën që kam prenotuar në Vlorë, shumën prej 5.000 eurosh.*

97.4. Në DIPP-2016, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka deklaruar se: *I detyrohem firmës së ndërtimit për apartamentin që kam blerë në Vlorë me kontratë, datë 6.11.2014, shumën prej 5.000 eurosh.*

97.5. Me kontratën paraprake të shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 6.11.2014, është parashikuar se çmimi për apartamentin me sipërfaqe 105 m², është në vlerën totale 30.000 euro dhe se është likuiduar vlera e kaparit prej 15.000 eurosh nga blerësi në Bankën Societe Generale Albania, në llogarinë për klientë të noteres L. C., sipas mandatit të datës 8.10.2014, pagesë për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK. Kësti me vlerë 5.000 euro do të likuidohet nga pala blerëse deri në datën 31.12.2014, dhe kësti me vlerë 10.000 euro do të likuidohet nga pala blerëse deri në datën 30.6.2015.

97.6. Në dokumentacionin shoqërues të deklaratës *vetting*, janë bashkëlidhur nga subjekti, ndër të tjerë, edhe: a) mandatderdhjeje *cash* në llogari të noteres L. C., në Bankën Societe Generale Albania, nga subjekti i rivlerësimit në datën 8.10.2014, shuma 15.000 euro, me përshkrimin: *Pagesë, kësti i dytë për blerje apartamenti te shoqëria “{***}” SHPK*; b) mandatderdhjeje *cash* në llogari të shoqërisë “{***}” SHPK, në Bankën “Societe Generale Albania”, nga subjekti i rivlerësimit në datën 23.12.2014, shuma 5.000 euro, me përshkrimin: *“Dritan Marku, të ardhura kursime, pag. këst apartamenti”*; c) mandatarkëtimi i shoqërisë “{***}” ShPK nr. {***}, datë 5.4.2015, me anë të të cilit është arkëtuar nga Dritan Marku, shuma 5.000 euro, me përshkrim: *Likuidim kësti.*

98. Rezulton se ndërsa në DIPP-2014, subjekti ka deklaruar prenotimin e banesës me sip. 94,65 m² në shumën 30.000 euro dhe në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka deklaruar se: *I detyrohem firmës së ndërtimit për banesën që kam prenotuar në Vlorë, shumën 10.000 euro*, ai nuk rezulton të ketë deklaruar shlyerjen e shumës 15.000 euro në datën 08.10.2014, dhe asaj 5.000 euro në datën 23.12.2014. Po ashtu, megjithëse në DIPP-2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjatë vitit ka marrë nga shtetasi A. D. shumën prej 15.000 eurosh, shumë e cila vjen nga shitja e banesës në Vlorë në vitin 2013, nuk rezulton që ai të ketë deklaruar se kjo shumë ka shërbyer si e ardhur për porositjen e apartamentit te shoqëria “{***}” ShPK apo të ketë deklaruar pakësimin e kësaj shume në favor të shlyerjes së detyrimit ndaj kësaj shoqërie sipas mandatpagesës, datë 08.10.2014. E njëjta situatë rezulton edhe sa i takon pagesës së shumës prej 5.000 eurosh, të kryer më datë 05.04.2015, për të cilën subjekti i rivlerësimit në DIPP-2015, rezulton të ketë deklaruar vetëm pakësimin e detyrimit, por nuk ka deklaruar pagesën e kryer në shumën 5.000 euro, si dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për këtë pagesë.

99. Lidhur me burimin financiar të të ardhurave të pretenduara nga kontrata e kaparit, të cilat subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar në deklaratën *vetting* si burim për pagesën e çmimit të pasurisë objekt shqyrtimi, në vijim të konkluzioneve që trupi gjykues ka arritur më lart në këtë vendim për dështimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar përfitimin e të ardhurave të

ligjshme nga kontrata e kaparit për apartamentin në Vlorë, e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për moskonsiderimin e tyre si burim financiar i ligjshëm për pasurinë objekt kontrolli.

100. Lidhur me huanë e pretenduar nga vjehri si burim për pagesën e kështit prej 5.000 eurosh në datën 5.4.2015, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar atë as në DIPP-në e vitit 2015 dhe as deklaratën *vetting* si burim për krijimin e kësaj pasurie dhe nuk ka gjurmë të marrjes apo të shlyerjes së këtij detyrimi, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit për moskonsiderimin e saj si burim financiar i ligjshëm.

101. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se lidhur me pasurinë “*apartment banimi*”, me sipërfaqe 94,65 m², ndodhur në Vlorë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Lidhur me pasurinë automjet, tip “Volkswagen Golf”, në përdorim:*

102. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me pasurinë automjet, tip “Volkswagen Golf”, ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit se: *ky automjet është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, i cili në lidhje me këtë pasuri gjendet në situatën e parashikuar prej pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

103. Këtë vlerësim, Komisioni e ka bërë bazuar në këto fakte: *(i) marrëdhënia e përdorimit të subjektit mbi një automjet, e cila nuk deklarohet gjatë viteve; (ii) përdorimi i këtij automjeti, i cili figuron në emër të kumatit të tij, i cili nuk provon përdorimin mbi të; (iii) mungesa e burimeve të ligjshme të blerësit për kryerjen e këtij investimi, larg vendit ku banonte e jetonte; (iv) gëzimi dhe përdorimi i tij, jo prej pronarit por prej subjektit.*

104. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar si të gabuar vlerësimin e Komisionit, pasi, sipas tij, nga analiza e të gjitha fakteve dhe provave, rezulton se automjeti me targë {***}, është në pronësi faktike dhe juridike të kumatit të tij, z. D. LL. Shkakun e ankimit, ankuesi e ka bazuar në pretendimet se: *(i) e ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklaratën vetting, në përputhje me përcaktimet ligjore, ndërsa ky deklarim nuk ka qenë detyrim ligjor në deklaratat periodike vjetore; (ii) automjeti është përdorur nga kunati i ankuesit gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri, ndërsa ai dhe familja e tij e kanë përdorur këtë mjet në udhëtime të gjata ose udhëtime jashtë vendit, sipas kontratës së huapërdorjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2014, për shkak se makina e tij nuk ishte në gjendje të mirë mekanike; (iii) nga analiza e të gjitha provave dhe fakteve të pasqyruara në aktet e administruara, rezulton se ky automjet është në pronësi faktike dhe juridike të kumatit dhe po ashtu provohet mundësia financiare e këtij të fundit për blerjen e kësaj pasurie, dhe se përdorimi i mjetit nga ana e tij është bërë sipas kontratës së huapërdorjes; (iv) automjeti është blerë nga kunati në Gjermani dhe pagesa në shumën 7.000 euro për blerjen, është bërë nga kunati i tij; (v) të gjitha siguracionet vjetore për këtë automjet, janë në emër të kumatit D. LL.; (vi) kunati i subjektit ka jetuar dhe punuar në mënyrë të rregullt në Itali dhe të ardhurat e realizuara prej tij, për periudhën 2008-2013, rezultojnë në shumën 101.482 euro *neto*.*

105. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e ankuesit, konstaton si më poshtë.

105.1. Në lidhje me këtë automjet, subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar: *Kam në përdorim një automjet, tip "Volkswagen Golf", me targë {***}, por nuk i ka bashkëlidhur kësaj deklaratë dokumentacion justifikues ligjor.*

105.2. Automjeti, tip "Volkswagen Golf", është blerë në vitin 2014 në Gjermani, me çmimin 6.000 euro, nga kunati i subjektit të rivlerësimit, z. D. LL., i cili ka kryer pagesën e çmimit dhe ka kryer procedurat e zhdoganimit dhe është pajisur me lejen përkatëse për qarkullimin e mjetit. Po ashtu, rezulton se policat vjetore të sigurimit janë në emër të z. D. LL.⁵⁰.

105.3. Referuar kontratës së huapërdorjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2014, kunati D. LL. ka autorizuar subjektin e rivlerësimit për përdorimin pa afat të këtij automjeti në Shqipëri dhe jashtë vendit.

105.4. Para vitit 2017, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ligjor për të deklaruar në DIPP-të vjetore, përdorimin e këtij automjeti.

105.5. Komisioni, në arsyetimin e vendimit, nuk ka treguar analizën e provave që e ka çuar në arritjen e konkluzionit se kunati i subjektit, z. D. LL., nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e automjetit, por është mjaftuar me argumentin se e ka nxjerrë këtë përfundim bazuar në bindjen e brendshme të trupit gjykues.

106. Bazuar në situatën e mësipërme faktike, trupi gjykues vlerëson se dyshimi i ngritur nga Komisioni se ky automjet është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, nuk është konfirmuar në mënyrë të plotë dhe të qartë nga provat e administruara gjatë procesit në Komision dhe, për pasojë, subjekti nuk duhet të konsiderohet se, lidhur me këtë pasuri, gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa "c" e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Lidhur me pasuritë e paluajtshme tokë arë: me sipërfaqe 440 m², me sipërfaqe 1176 m² dhe me sipërfaqe 1725 m², të ndodhura në fshatin {***}, Lezhë:*

107. Lidhur me pasuritë e paluajtshme tokë arë me sipërfaqe 440 m², me sipërfaqe 1176 m² dhe sipërfaqe 1725 m², të ndodhura në fshatin {***}, Lezhë, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vlerësimin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me këto pasuri, sipas parashikimeve të germës "a" të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

108. Komisioni ka bazuar vlerësimin e tij në konstatimin se pjesëtarët e tjerë të familjes së subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e bashkëpronarit mbi tokën që familja kishte fituar bazuar në ligjin nr. 7501/1991, "Për tokën", nuk kanë shprehur vullnetin në blerjet e realizuara nga subjekti prej babait të tij.

⁵⁰ Për periudhën 22.10.2014 - 21.10.2016, pranë shoqërisë "SIGAL" ShA; për periudhën 21.10.2016 - 20.10.2017, pranë shoqërisë "ANSIG" ShA; për periudhën 20.10.2017 - 19.10.2018, pranë shoqërisë "ATLANTIK" ShA; për periudhën 03.02.2019 - 21.02.2021, pranë shoqërisë "SIGAL" ShA.

109. Ankuesi e ka kundërshtuar këtë vlerësim të Komisionit, duke pretenduar se ai nuk bazohet në parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksin e Kushtetutës. Prindërit dhe vëllezërit e tij nuk kanë hequr dorë nga këto pasuri, por i kanë shitur ato dhe të ardhurat janë përfituar dhe përdorur nga familja bujqësore. Kontratat e shitjes së këtyre pasurive janë regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe, nga analiza financiare e kryer, rezulton se ankuesi ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive.
110. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e ankuesit, konstaton si më poshtë.
- 110.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Kam blerë nga babai im në vitin 2005, një pasuri tokë arë, me sip. 440 m², me kontratë noteriale. Kjo pasuri, si dhe të tjerat të kësaj natyre, janë përfituar nga familja ime (duke më përfshirë edhe mua), me ligjin nr. 7501, "Për tokën". Vlera: 50.000 lekë. Kontratë noteriale, datë 23.12.2005. E kam shitur këtë pasuri tokë arë me sip. 440 m² në vitin 2008, me kontratë noteriale. Vlera: 113.520 lekë. Kontratë noteriale, datë 23.10.2008.*
- Kam blerë nga babi im në vitin 2012, dy sipërfaqe toke arë, pasuria nr. {***}, e llojit arë me sipërfaqe 1176 m² dhe pasuria me nr. {***} po e llojit arë me sipërfaqe 1725 m². Këto dy pasuri janë përfituar nga familja ime (duke përfshirë edhe mua) me ligjin nr. 7501 "Për tokën". Bashkëlidhur dokumentacioni përkatës plus AMTP.*
- 110.2. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar blerjen e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 440 m², nga babai i tij, në vlerën 50.000 lekë, me anë të kontratës noteriale të datës 23.12.2005, si dhe regjistrimin pranë ZVRPP-së, Lezhë, me anë të vërtetimit të pronësisë nr. {***}, datë 19.1.2006.
- 110.3. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar shitjen e kësaj pasurie me kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.10.2008, me çmim 113.520 lekë.
- 110.4. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti, në rubrikën "Ndryshim i pasurisë", ka deklaruar blerjen nga babai të dy pasurive me sipërfaqe 1176 m² dhe 1725 m², në shumën 742.656 lekë.
- 110.5. Me kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.5.2012, lidhur ndërmjet palës shitëse L. dhe D. M. (prindërit e subjektit) dhe subjektit të rivlerësimit si palë blerëse, janë shitur dy sipërfaqe tokë arë, me sipërfaqe 1176 m² dhe 1725 m², të ndodhura në fshatin {***}, Lezhë, me çmim 301.056 lekë dhe 441.600 lekë, në total në vlerën 742.656 lekë.
- 110.6. Pas kalimit të pronësisë në emër të subjektit të rivlerësimit, ai është pajisur me certifikatat përkatëse për vërtetim pronësie.
111. Trupi gjykues, bazuar në situatën e mësipërme faktike, vlerëson se në kushtet kur nga ana e Komisionit, në arsyetimin e vendimit, nuk është konstatuar mungesë e burimeve financiare të ligjshme e subjektit të rivlerësimit për burimin e krijimit të pasurive tokë arë, analiza e Komisionit në lidhje me elemente formale juridiko-civile, nuk ka ndikim në vlerësimin e

kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, si rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit gjendet i pabazuar.

112. Bazuar në konkluzionet e mësipërme për secilën prej pasurive objekt kontrolli, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke u gjendur në kushtet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 411, datë 05.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i mbështetur në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 411, datë 05.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Marku.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 04.02.2025.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi